Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ Prishtinë/Priština, Kosovo | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

Raporti vjetor 2015/2016

Parathënie

Ky është raporti i tetë dhe i fundit vjetor i Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Ai e përfshin një periudhë më të gjatë sesa raportet nga vitet paraprake; nga 1 janari i vitit 2015 deri më 31 maj 2016, data kur Paneli miratoi mendimin e tij të fundit, duke përfunduar kështu të gjitha rastet në listën e vet të çështjeve gjyqësore.

Gjatë kësaj periudhe, Paneli dha një numër mendimesh të rëndësishme në rastet e ngjashme për nga natyra me llojin e rasteve që e kanë përbërë një pjesë të konsiderueshme të ngarkesës me punë të Panelit gjatë disa viteve të mëparshme. Këto lëndë kishin të bënin me mungesën e pretenduar të hetimeve adekuate penale në lidhje me zhdukjet, rrëmbimet dhe vrasjet, në pajtim me obligimet procedurale që dalin sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe shkeljeve të pretenduara të nenit 3 të KEDNJ-së për sa i përket trajtimit johuman dhe degradues të anëtarëve të familjes dhe të afërmve të tjerë të ngushtë të viktimave.

Në mesin e këtyre rasteve, duhet kushtuar vëmendje disa mendimeve të veçanta pasi ato kanë paraqitur çështje të reja që nuk janë diskutuar më herët në jurisprudencën e Panelit: *S.M.*, lidhur me një sulm ndaj ankueses në shtëpinë e saj në fshatin Bellopole më 26 qershor 1999 që përfshinte lidhjen e syve të saj dhe lidhjen e saj për një karrige për të dëgjuar në kohën që tre persona dhunuan dhe vranë vajzën e saj që ishte mentalisht dhe fizikisht e paaftë; *Kostiq dhe të tjerët*, lidhur me rrëmbimet që kanë ndodhur gjatë një sulmi të armatosur të UÇK-së në fshatrat Opterushë dhe Retimle duke përfshirë privimin e ankuesve nga liria për katër ditë; dhe *Milenkoviq*, në të cilin Policia e UNMIK-ut e vonoi për 15 vjet kthimin e mbetjeve mortore të vëllait të ankuesit, i cili është zhdukur në nëntor të vitit 1999 dhe ishte vrarë.

Paneli është vënë në dijeni se ka konsiderueshëm më shumë familje që dëshirojnë të paraqesin ankesa të ngjashme në PKDNJ lidhur me shkeljet e pretenduara nga ana e UNMIK-ut të neneve 2 dhe 3 të KEDNJ-së, por këto familje mbetën të përjashtuara nga nxjerrja e papritur e Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2009/01 të 17 tetorit të vitit 2009, i cili arbitrarisht vendosi 31 marsin e vitit 2010 si datë të fundit për juridiksionin e përkohshëm të Panelit për të pranuar ankesa.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Paneli po ashtu përfundoi rastet në lidhje me situatat e tjera, nga të cilat vëmendje e veçantë duhet kushtuar dy mendimeve. I pari, *Balaj dhe të tjerët*, lidhur me përdorimin e tepërt të dhunës gjatë një operacioni për kontroll të turmës në shkurt të vitit 2007, i cili rezultoi me vdekje dhe plagë serioze trupore të disa viktimave. I dyti, *N.M. dhe të tjerët*, ka të bëjë me pretendimet në lidhje me helmimin nga plumbi dhe problemet e tjera shëndetësore për shkak se UNMIK-u i kishte vendosur pjesëtaret e komunitetit RAE në kampe të kontaminuara në Kosovën Veriore për shumë vjet.

Sikur në vitet paraprake, duhet të theksohet se shqyrtimi nga ana e Panelit i të gjitha rasteve, shumë nga të cilat ishin jashtëzakonisht komplekse, nuk do të ishte i mundur pa juristët dhe personelin administrativ të cilët e përbëjnë Sekretariatin e Panelit në profesionalizmin e lart të të cilëve Paneli gjithmonë mund të llogariste.

Po ashtu, sikur në raportet e mëparshme vjetore, unë duhet ta potencojë përsëri me keqardhje të madhe problemin e përgjithshëm strukturor që ekziston, për të qenë më specifik mungesën e implementimit të mendimeve të Panelit, veçanërisht për sa i përket pagesës nga ana e UNMIK-ut të kompensimit financiar ankuesve si dhe mungesën e progresit të rëndësishëm të EULEX-it apo institucioneve të Kosovës për zbatimin e ligjit në vazhdimin e hetimeve lidhur me rastet e Panelit në lidhje me rrëmbimet, zhdukjet dhe vrasjet. Mbetet shpresa se së paku disa nga këto raste do ta gjejnë rrugën e tyre për në listën e çështjeve gjyqësore të tribunalit të veçantë që është duke u krijuar nga komuniteti ndërkombëtar dhe autoritetet e Kosovës – Gjykata e Zhvendosur Speciale e Kosovës (KSJI) – juridiksioni i së cilës përfshin "krimet serioze që pretendohet të jenë kryer në vitin 1999-2000 nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kundër minoriteteve etnike dhe kundërshtarëve politikë."

Në kohën e fundit Paneli është i përfshirë në përgatitjen e publikimit të raportit të tij të fundit, i cili do të përfshijë krejt periudhën e aktivitetit dhe trashëgimisë së vet. Ai po ashtu do të përfshijë analiza, reflektime dhe përfundime të komunitetit ndërkombëtar me qëllim dhënien e rekomandimeve rreth asaj se si një Panel i tillë mund të funksionojë efektivisht, dhe se a duhet një Panel i tillë të formohet nga komuniteti ndërkombëtar në të ardhmen. Pavarësisht nga ajo se çfarë pranohet zyrtarisht si sukses i këtij Paneli, ai padyshim ka qenë një eksperiment i rëndësishëm në fushën e përgjegjësisë për të drejtat e njeriut të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare.

Marek Nowicki

kryesues

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

mars 2016

Përmbajtja

1. **Hyrje** 1
2. **Përbërja e Panelit** 2
   2.1. Anëtarët e Panelit..... 2
   2.2. Stafi i Sekretariatit..... 4
3. **Mbulimi i aktivitetit të PKDNJ-së nga mediet dhe OJQ-të** ……..... 6
4. **Ngarkesa me lëndë e Panelit**..... 8
   4.1. Statistikat..... 8
   4.2. Mendimet e Panelit të përzgjedhura sipas lëndës 8
5. **Jurisprudenca e Panelit** 9
   5.1. E drejta në jetë - e drejta për hetim efektiv – e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues – e drejta për tubim paqësor –neni 2 i KEDNJ-së 9
   5.2. E drejta në jetë - e drejta për hetim efektiv - neni 2 i KEDNJ-së..... 12
   5.3. E drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues– neni 3 i KEDNJ-së…….. 14
   5.4. E drejta në jetë – neni 2 i KEDNJ-së – e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues – neni 3 i KEDNJ-së dhe e drejta në jetë familjare – neni 8 i KEDNJ-së…… 17
   5.5. E drejta në jetë (procedurale) – e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues – e drejta për hetim efektiv – Të drejtat sipas KEDKG-së…….. 18
   5.6. E drejta në liri – e drejta për hetim efektiv – neni 5 i KEDNJ-së..... 20
   5.7. E drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues – e drejta në sigurim social dhe standard adekuat të jetesës…….. 21
   5.8. E drejta në sigurim social – e drejta në standard adekuat të jetesës– e drejta për qasje në gjykatë – e drejta për mjet efektiv juridik …….. 26
6. **Rekomandimet e Panelit**..... 27
7. **Reagimet e UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit**..... 29
8. **Lista e shtojcave**..... 31
   Shtojca A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12.....… 31
   Shtojca B: Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2009/1..... 38
   Shtojca C: Tabela statistikore e PKDNJ-së..... 41
   Shtojca D: Lista e vendimeve dhe mendimeve të PKDNJ-së të marra në vitin 2015 dhe 2016 ... 42
   Shtojca E: Vendimet dhe mendimet e miratuara sipas vitit..... 44
   Shtojca F: Rastet e mbyllura të PKDNJ-së (të papranueshme, të hedhura poshtë dhe mendim mbi bazueshmërinë) sipas vitit..... 44
   Shtojca G: Shkurtesat dhe akronimet..... 45

1. Hyrje

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli), i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të 23 marsit të vitit 2006,[1] vazhdoi t'i shqyrtojë ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut të kryera nga Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), apo që i atribuohen atij, gjatë gjithë periudhës së funksionimit të tij (2007-2016) në Prishtinë, Kosovë. Paneli mbetet mekanizmi i vetëm që merret me shkeljet e të drejtave të njeriut, që pretendohet se janë kryer nga Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo që i atribuohen atij. Edhe pse Paneli nuk mund të urdhërojë kompensim apo ndihmë specifike, Paneli mund të vendosë nëse UNMIK-u është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe, nëse ky është rasti, ai mund t'i japë rekomandime Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) lidhur me kompensimin dhe ndihmën tjetër specifike.

2. Duke punuar me personel të plotë të Sekretariatit, Paneli ishte në gjendje ta ketë një periudhë të suksesshme përfunduese, duke shqyrtuar një vëllim të madh të ankesave si dhe duke përfshirë shqyrtimin e ankesave që ngritën çështjet më komplekse të të drejtave të njeriut që i janë paraqitur Panelit. Ky raport vjetor përfshin periudhën 1 janar 2015 deri më 31 maj 2016, gjatë së cilës kohë Paneli mbajti gjashtëmbëdhjetë seanca, duke përfshirë shqyrtimet përmes mjeteve elektronike. Gjatë kësaj periudhe, Paneli miratoi 51 mendime mbi bazueshmërinë (në lidhje me 88 ankesa) dhe e hodhi poshtë një kërkesë për rishikim të vendimeve të mëparshme. Nga to, 79 mendime ishin për ankesat në lidhje me personat e zhdukur dhe të vrarë (PZHV).

3. Paneli tani e ka përfunduar listën e vet të plotë të çështjeve gjyqësore prej 527 ankesash të regjistruara që i ka pranuar nga fillimi i punës së Panelit dhe përfundoi punën e vet për çështjen gjyqësore në të gjitha lëndët në zhvillim e sipër.

4. Në vitin 2015, anëtarët e Panelit u takuan me një delegacion të Grupit Punues të OKB-së për zhdukjet e imponuara dhe të pavullnetshme. Përveç kësaj në vitin 2015, anëtarët e Panelit dhe Sekretariati mbajtën lidhje me Panelin për Shqyrtim të të Drejtave të Njeriut të EULEX-it dhe diskutuan çështjet me interes të dyanshëm.

5. Në vitin 2015, Paneli dhe Sekretariati vazhduan me përdorimin e gjerë të burimeve të tjera për të mbledhur informata, të cilat nuk ishin në gjendje t'i mbledhin nga ankuesit apo parashtresat e PSSP-së për Panelin. Për shembull, Panelit iu ofruan informata jashtëzakonisht të dobishme, duke përfshirë dokumente relevante hetimore që kanë qenë para kësaj të paarritshme, nga Zyra e prokurorit të shtetit përkatësisht Zyra e kryeprokurorit të shtetit të Kosovës, kryeprokurori nga Prokuroria Themelore në Prizren, Policia e UNMIK-ut dhe Policia e Kosovës. Informatat e marra iu komunikuan të gjitha palëve në ankesat para Panelit.

[1] Bashkëngjitur si shtojca A.

6. Sekretariati gjithashtu vuri kontakt me ankuesit individualë, si dhe organizatat që kanë lidhje me rastet, siç janë Shoqata e Familjeve të të Rrëmbyerve dhe Vrarëve në Kosovë dhe Metohi për të mbledhur informata relevante kur kërkohet. Përveç kësaj, Sekretariati rregullisht u mbështet në informatat e publikuara në bazat e të dhënave 'online' të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK)[2] dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (KNPZH)[3], si dhe informatat e përmendura nga Qendra për të Drejtën Humanitare.[4]

2. Përbërja e Panelit

2.1 Anëtarët e Panelit

7. Tre anëtarët e Panelit, të emëruar nga kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të (ri)emëruar nga PSSP-ja në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12, më 1 janar të vitit 2015 dhe 1 janar 2016 ishin z. Marek Nowicki (Poloni), znj. Christine Chinkin (Mbretëria e Bashkuar/Australi) dhe znj. Françoise Tulkens (Belgjikë)[5]. Paneli e zgjodhi z. Marek Nowicki si kryesues të tij në janar të vitit 2008 dhe e rizgjodhi atë si kryesues në vitin 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014,2015 dhe 2016[6].

8. Informatat për biografinë e anëtarëve të Panelit janë dhënë më poshtë.

9. **Marek A. Nowicki** (janar 2007- aktualisht) shtetas polak, avokat i të drejtave të njeriut dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Varshavës që nga viti 1987.

10. Z. Nowicki ishte Ombudsperson ndërkombëtar në Kosovë i emëruar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, prej korrikut të vitit 2000 deri në dhjetor të vitit 2005. Ai ishte anëtar i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, nga marsi i vitit 1993 deri më 31 tetor 1999, dhe ishte anëtar nga Polonia i Rrjetit të Bashkimit Evropian të ekspertëve të pavarur për të drejtat themelore nga marsi i vitit 2003 deri në shtator të vitit 2006. Më 2005 ai u emërua nga Komisioni i Ministrave si njëri prej tre kandidatëve për postin e Komisarit për të Drejta të Njeriut të Këshillit të Evropës.

11. Z. Nowicki ishte njëri nga "juristët eminentë" të emëruar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për të vlerësuar gjendjen ligjore dhe të të drejtave të njeriut në Moldavi (1994) dhe Azerbajxhan (1997). Në vitin 1996 dhe 1998, Këshilli i Evropës i kërkoi atij të shërbejë si ekspert për të drejtat e njeriut gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së sistemeve ligjore të Gjeorgjisë dhe Federatës Ruse me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai shërbeu si ekspert për të drejtat e njeriut i Komisionit Evropian për

---

[2] Lista e KNKK-së është në dispozicion në http://familylinks.icrc.org/kosovo/en/pages/search-persons.aspx

[3] Baza e të dhënave e KNPZH-së është në dispozicion në: http://www.ic-mp.org/fdmsweb/index.php?w=mp_details&l=en

[4] Shih: *Rrëmbimet dhe zhdukjet e joshqiptarëve në Kosovë. 24 mars 1999 – 31 dhjetor 2000*, f. 12 // faqja e internetit e QDH-së [burimi elektronik] - http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/02/KO-Abductions-and-disappearances-of-non-Albanians-in-Kosovo-1.pdf (e qasur më 20 mars 2015)

[5] Emërimi dhe riemërimi i znj. Tulkens nga PSSP-ja përfshinë periudhën e njëjtë por ishte në fuqi prej 14 shtatorit të vitit 2012 deri më 13 shtator të vitit 2013, 14 shtatorit të vitit 2013 deri më 13 shtator të vitit 2014 dhe 14 shtator të vitit 2014 deri më 13 shtator të vitit 2015.

[6] Shih: Rregullorja e punës e PKDNJ-së, rregulla 6.

Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venedikut) dhe në Drejtorinë e përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Ligjore të Këshillit të Evropës.

12. Z. Nowicki ishte anëtar themelues i Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Varshavë dhe kryetar i tij prej nëntorit të vitit 2003 deri në shkurt të vitit 2008. Aktualisht ai e kryeson Këshillin e Fondacionit. Z. Nowicki është autor i dhjetëra librave dhe qindra artikujve mbi të drejtat e njeriut, të publikuara në Poloni dhe në vendet e tjera. Ai është anëtar i Komisionit përzgjedhës të Çmimit Vaclav Havel për të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

13. **Christine Chinkin** (shkurt 2010- aktualisht) me shtetësi të dyfishtë britanike/australiane, anëtare e Akademisë Britanike, është aktualisht profesoreshë e së Drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Ekonomik të Londrës dhe drejtoreshë e Qendrës për Gra, Paqe dhe Siguri në FEL. Ajo është po ashtu profesoreshë e së Drejtës globale në Fakultetin e Drejtësisë William C. Cook të Universitetit të Miçigenit. Ajo është anëtare e Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit dhe anëtare akademike e Matrix Chambers. Ajo është diplomuar në drejtësi në Universitetin e Londrës, Jelit dhe Sidnejit dhe ka mbajtur më parë poste akademike me orar të plotë në Universitetin e Oksfordit, Londrës, Sidnejit dhe Sauthemptonit, në Fakultetin e Drejtësisë në Nju Jork dhe në Universitetin Kombëtar të Singaporit.

14. Interesimet kryesore të znj. Chinkin janë e drejta ndërkombëtare publike, veçanërisht e drejta për traktatet, të drejtat e njeriut, me theks në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të grave dhe organizatat ndërkombëtare, dhe zgjidhjen e konflikteve vendore dhe ndërkombëtare. Ajo është autore e shumë artikujve mbi çështjet që ndërlidhen me të drejtën ndërkombëtare publike dhe të drejtat njerëzore të grave, ligjet e Halsburit në Australi, E drejta në marrëdhëniet me jashtë (edicioni i 2-të 2001), Palët e treta në të drejtën ndërkombëtare (1993), bashkautore e Zgjidhja e konfliktit në Australi (edicioni i 2-të 2002), bashkautore e Kufijtë e të drejtës ndërkombëtare: Një analizë feministe (2000) dhe bashkautore e Krijimit të së drejtës ndërkombëtare (2007), bashkëredaktore e Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (2012) dhe Sovraniteti, Shtetësia dhe përgjegjësia e Shtetit (2015). Nga viti 2004-2012, ajo ishte drejtoreshë e studimeve në Asociacionin Ndërkombëtar për të Drejtën. Ajo është anëtare e Institutit të IBA-s për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Në prill të vitit 2001 asaj iu nda Certifikata për meritë, e Asociacionit Amerikan për të Drejtën Ndërkombëtare për ‘kontribut të jashtëzakonshëm për diturinë’ dhe në vitin 2006 Medalja e Asociacionit Goler T. Butcher për ‘kontribute të jashtëzakonshme për zhvillimin apo realizimin efektiv të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut' (me H. Charlesworth).

15. Znj. Chinkin ka qenë konsulente për të drejtën ndërkombëtare e Bankës Aziatike për Zhvillim; për trafikim të grave në Zyrën e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të OKB-së si dhe për Marrëveshjet e Paqes dhe Çështjet Gjinore në Divizionin e OKB-së për Avancimin e Grave dhe UNIFEM. Ajo ishte eksperte shkencore në një Komision ad hoc të Këshillit të Evropës për hartimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje të vitit 2011. Ajo ishte anëtare e misionit faktmbledhës në Beit Hanoun në pajtim me Rezolutën e Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Organizatës

së Kombeve të Bashkuara S 3/1, maj 2008 dhe misionit faktmbledhës të OKB-së në konfliktin e Gazës në vitin 2009, si dhe misionit faktmbledhës të Këshillit për DNJ të IBA-s përkitazi me sundimin e ligjit në Malavi, në janar të vitit 2012.

16. **Françoise Tulkens** (shtator 2012- aktualisht), shtetase e Belgjikës, ka një doktoratë në drejtësi, magjistraturë në penologji dhe ka diplomuar për mësimdhënie në arsim të lartë (*agrégation de l'enseignement supérieur*) në fushën e drejtësisë.

17. Ajo ishte hulumtuese në Institutin Max Planck për të Drejtën ndërkombëtare dhe të jashtme penale (Freiburg-im-Breisgau, Gjermani). Ajo ishte profesoreshë në Universitetin Louvain (Belgjikë) dhe ka dhënë mësim në Belgjikë dhe gjithashtu jashtë vendit– si profesoreshë vizitore e Universitetit të Gjenevës, Montrealit, Otavës, Parisit I, Renes, Strasburgut dhe Universitetit Shtetëror të Luizianës – në fushën e së Drejtës penale (pjesa e përgjithshme), E drejta krahasuese dhe penale evropiane, E drejta e të miturve dhe sistemet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

18. Nga nëntori i vitit 1998 deri në shtator të vitit 2012, ajo ishte gjyqtare në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke shërbyer si kryetare e sektorit nga janari i vitit 2007 dhe si nënkryetare e Gjykatës nga shkurti i vitit 2011.

19. Znj. Tulkens është autore e shumë publikimeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtës penale, si dhe bashkautore e librave për referim si: *Introduction au droit penal. Aspects juridiques et criminologiques* (edicioni i 9^{të}, 2010) dhe *Droit de la Jeunesse : Aide, Assistance et Protection* (2000). Ajo gjithashtu bashkëredakton: *Code de droit international humanitaire* (edicioni i 6^{të}, 2013), *Kodi i të Drejtës ndërkombëtare humanitare* (edicioni i 1^{rë}, 2013) dhe *Code de droit international des droits de l'homme* (edicioni i 5^{të}, 2014). Ajo është anëtare e bordeve editoriale të një numri revistash shkencore, në mes tjerash *Revue trimestrielle des droits de l'homme*, *Revista mbi drejtësinë ndërkombëtare penale* dhe *Revista ndëramerikane dhe evropiane për të drejtat e njeriut*.

20. Në vitin 2013 ajo është emëruar si anëtare e Komisionit Shkencor të Agjencisë për të Drejta Themelore (ADTH) të Bashkimit Evropian. Ajo është anëtare e Komisionit Shkencor të Institutit për të Drejtat e Njeriut të Odës së Avokatëve të Brukselit dhe Bordit të Drejtorëve të Akademisë për të Drejtën Evropiane.

21. Ajo mban doktorata nderi nga universitetet e Gjenevës, Limozhit, Otavës dhe Gentit. Ajo është anëtare me korrespondencë e Akademisë Mbretërore të Belgjikës për Shkencë, Letërsi dhe Arte, që nga viti 2011.

22. Znj. Tulkens aktualisht është kryetare e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Mbreti Baudouin.

2.2 Stafi i Sekretariatit

23. Stafi i Sekretariatit përbëhet nga një zyrtar ekzekutiv, tre zyrtarë ligjorë dhe dy asistente administrative.

24. **Andrey Antonov**, shtetas rus, iu bashkua Sekretariatit në qershor të vitit 2011 si zyrtar ekzekutiv. Më herët z. Antonov punoi si hetues në Divizionin për hetime të Zyrës për Kontroll të Brendshëm në selinë e OKB-së (2011), si zyrtar për disiplinë dhe sjellje në misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Sudan (2009-2011), si këshilltar ligjor në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2008-2009), si zyrtar ligjor në Divizionin penal të Departamentit të Drejtësisë (DD) të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) (2005-2008), dhe si zyrtar ligjor në Sektorin për Integrime Gjyqësore të DD-së së UNMIK-ut (2003-2005). Para se t'i bashkohej Organizatës së Kombeve të Bashkuara, z. Antonov shërbeu në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Rusisë (MPB), si hetues penal në Departamentin për transport të policisë (Anapa, 1996), dhe ligjërues i lartë mbi procedurën penale dhe hetimin penal (Universiteti i Krasnodarit, MPB e Rusisë, 1999-2003). Ai arriti së pari në Kosovë në vitin 2000 si pjesëtar i kontingjentit rus të policisë, i dërguar nga MPB-ja ruse për të shërbyer në Policinë e UNMIK-ut, ku punoi si zyrtar ligjor në Zyrën ligjore të Komisarit të Policisë së UNMIK-ut deri në vitin 2002. Z. Antonov mban gradën e doktoratës në drejtësi (PhD), i specializuar në procedurën penale, hetimin penal dhe zbulimin e krimit nga Akademia Ligjore e Volgogradit e MPB-së ruse dhe një magjistraturë në drejtësi (LLM) nga i njëjti institucion. Ai është gjithashtu autor i më shumë se 30 publikimeve në periodikët rusë në lidhje me aspekte të ndryshme të hetimeve penale.

25. **Anna Maria Cesano**, shtetase italiane, iu bashkua Sekretariatit si zyrtare ligjore në maj të vitit 2011. Më herët, znj. Cesano punoi si zyrtare për sundim të ligjit në Programin për qasje në drejtësi të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2010-2011), si zyrtare për ndërlidhje në Zyrën e Komisarit për Refugjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Tanzani (2009) dhe si zyrtare për të drejtat e njeriut në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2007-2009). Para se t'i bashkohej Organizatës së Kombeve të Bashkuara, znj. Cesano punoi në Universitetin e Sienës, Itali (2006-2007) si hulumtuese mbi sistemin evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Znj. Cesano filloi punën për herë të parë në Ballkan në vitin 2005 në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, në Serbi dhe Mal të Zi. Ajo ka magjistruar për të drejtat e njeriut dhe menaxhimin e konflikteve në Universitetin e Pizës për studime të avancuara Sant' Anna dhe mban një magjistraturë në drejtësi nga Universiteti Katolik i Milanos, Itali.

26. **Brandon Gardner**, shtetas amerikan dhe ish-anëtar i Odës së Avokatëve të Pensilvanisë, iu bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor në tetor të vitit 2011. Më herët, z. Gardner shërbeu si këshilltar ligjor në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në emër të Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (2009-2011).

    Para kësaj, z. Gardner shërbeu si zyrtar ligjor në Sektorin për marrëdhënie me jashtë të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut dhe në Zyrën ndërlidhëse për sundim të ligjit të UNMIK-ut (2007-2009). Z. Gardner gjithashtu ka ushtruar detyrën e avokatit në Pensilvani (2006-2007). Z. Gardner ka doktoruar në drejtësi në Universitetin e Pitsburgut si dhe ka diplomuar në shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Pitsburgut.

27. **R. Dule Vicovac**, një shtetas kanadez dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Manitobas në Kanada dhe Odës së Avokatëve të Minesotës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, iu

bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor në gusht të vitit 2014. Më herët z. Vicovac punoi si avokat në rastet penale dhe të refugjatëve në Kanada (2013-2014) pasi i kaloi mbi 12 vjet në ish-Jugosllavi. Ai po ashtu punoi si ekspert ligjor në një projekt të financuar nga BE-ja për ndihmë ligjore nëpërmjet të cilit ndihmoheshin personat e zhvendosur nga Kosova (2011-2012), si udhëheqës ekipi/ekspert ligjor në një projekt të financuar nga BE-ja në Ministrinë për të Drejtat e Njeriut & Minoritetet të Serbisë (2010-2011) dhe si ekspert ligjor në Këshillin Danez për Refugjatë për t'iu ndihmuar personave të zhvendosur në ish-Jugosllavi (2008-2009). Para kësaj z. Vicovac shërbeu si zyrtar ligjor në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut si ushtrues detyre i sekretarit në Divizionin për Përkrahje Ndërkombëtare Gjyqësore (2007- 2008) dhe si zyrtar i asociuar ligjor në Sektorin për Integrim Gjyqësor, (2002-2007). Z. Vicovac shërbeu si udhëheqës për rajonin, Pejë, Prizren & Mal të Zi, Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore, UN-Habitat (2002) dhe koordinator terreni, Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore, UN-Habitat (2000-2001). Z. Vicovac mban një titull doktorate në drejtësi nga Universiteti i Hamlinit për drejtësi në Minesota si dhe ndoqi Universitetin e Manitobas dhe Universitetin e Oksfordit. Ai ka diplomuar për drejtësi dhe të drejtën në Universitetin e Uinipegit (Winnipeg). Artikulli i tij i titulluar, "*Sfidat për ofrimin e ndihmës ligjore personave të zhvendosur pas një konflikti të armatosur, mësimet e marra në Kosovë*" ishte publikuar nga Revista e Oksfordit për mbikëqyrjen e praktikimit të të drejtave të njeriut.

28. **Adlije Muzaqi**, punonjëse e stafit vendor dhe asistente e ekipit, ka punuar në Sekretariat që nga shtatori i vitit 2010. Ajo filloi punën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 1999, si asistente administrative në Administratën komunale të UNMIK-ut në Komunën e Vushtrrisë, rajoni i Mitrovicës.

29. **Larisa Barishiq**, punonjëse e stafit vendor dhe asistente ligjore, iu bashkua Sekretariatit në tetor të vitit 2015. Para se t'i bashkohej Panelit ajo ka shërbyer për shumë vjet në Misionin në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim. Znj. Barishiq ka diplomuar në shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Beogradit dhe ndjek studimet e saj të magjistraturës në të drejtën ndërkombëtare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit.

2.3 Stafi i Sekretariatit që shërbeu në vitin 2015

30. **Snezhana Martinoviq**, punonjëse e stafit vendor dhe asistente ligjore ka punuar në Sekretariat që nga dhjetori i vitit 2007 deri në qershor të vitit 2015. Ajo filloi punën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në prill të vitit 2000, si asistente administrative në Departamentin e Policisë së UNMIK-ut. Në tetor të vitit 2002, ajo mori detyrën e asistentes administrative në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut. Tani ajo është duke punuar në Misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Liberi si asistente administrative e këshilltarit të veçantë politik të zëvendësit të PSSP-së.

3. Mbulimi i aktivitetit të PKDNJ-së nga mediet dhe OJQ-të

31. Në periudhën e raportimit, kishte një mbulim të rëndësishëm të mendimeve të Panelit për ankesat në lidhje me personat e zhdukur dhe të vrarë (PZHV), pasi fati i personave të tillë vazhdon të jetë një sferë për shqetësim në gjithë rajonin. Për shembull, më 12 nëntor 2015,

Vesti, një organizatë lajmesh e cila përhap raportimin e vet në gjithë botën serbishtfolëse përmes shtypit dhe në mënyrë elektronike përmes faqes së vet të internetit *Lajmet online (Vesti online)*, publikoi një storie në lidhje me reagimin e familjes ndaj mendimit të PKDNJ-së në njërin nga rastet e tij për PZHV-të, rastin *Kostiq*. Në storie theksohet se megjithëse PKDNJ ka gjetur se UNMIK-u shkeli nenet 2 dhe 3 të KEDNJ-së në lidhje me hetimin e tij joefektiv për rrëmbimin dhe vrasjen e anëtarëve të tyre të familjes, UNMIK-u nuk u kishte ofruar ndonjë kompensim familjeve. Në storie citohet një përfaqësuese e Asociacionit të Familjeve të të Rrëmbyerve dhe të Vrarëve në Kosovë, e cila tha se ky mendim i Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut është "hedhje hiri në sy" familjeve të cilat kërkojnë të zbulojnë të vërtetën rreth fatit të më të dashurve të tyre. Në storie thuhet:

> "[Ajo] deklaroi se mori vite derisa familjet e atyre të rrëmbyerve dhe të vrarëve në Kosovë kuptuan se mendimi i Panelit Këshillëdhënës, të cilin ata e pritën me padurim duke e menduar atë të jetë hapi më i rëndësishëm për të dëshmuar krimet, është asgjë më shumë se hedhje e hirit në sy. Paneli Këshillëdhënës është themeluar nga UNMIK-u; megjithatë, ai nuk i konfirmoi ato mendime të shumta të miratuara nga Paneli Këshillëdhënës me madje as me një për qind të veprimeve të veta. Madje fakti që misioni i tyre do të përfundojë së shpejti na tregon ne se ideja pas gjithë kësaj ishte të mashtrohemi duke na treguar të pavërtetat dhe të blihet kohë, sepse me këto mendime madje as një familje serbe apo joshqiptare nuk arriti përmbushjen e pritjeve të veta para gjykatës … Duke pasur parasysh se UNMIK-u nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim, Paneli Këshillëdhënës nuk ka kontribuar në ndonjë mënyrë çfarëdo qoftë ajo që e vërteta të zbulohet në një mënyrë më të shpejtë dhe të arrihet drejtësia për viktimat serbe."[7]

32. Gjatë periudhës së raportimit, Amnesty International (Amnestia Ndërkombëtare-AI) vazhdoi korrespondencën e vet me PSSP-në lidhur me mendimet e Panelit për PZHV-të. Më 22 shkurt 2016, Ai i dërgoi një letër PSSP-së, në të cilën përsëriti shqetësimet e veta në emër të ankuesve për mendimet e Panelit për PZHV-të. Në mënyrë specifike, AI theksoi që "shqetësimet [t]ona fokusohen në mohimin e vazhdueshëm të kenë mjete efektive juridike të afërmit e kryesisht serbëve të Kosovës anëtarët e familjes të të cilëve besohet të jenë rrëmbyer apo zhdukur gjatë dhe pas konfliktit të armatosur. Kjo mungesë e mjeteve juridike përfshin dështimin të sigurohet qasje në drejtësi dhe të marrin dëmshpërblim, duke përfshirë kompensimin, siç rekomandohet nga Paneli. Në pothuaj secilin rast… Paneli rekomandoi që UNMIK-u t'u paguajë viktimave kompensim, për dështimin për të hetuar dhe në disa raste, për shqetësimin dhe vuajtjen mentale të shkaktuar atyre nga ky dështim [dhe] që autoritetet relevante duhet të rihapin apo vazhdojnë me hetimet penale në rastet e vendosura nga PKDNJ."

33. AI po ashtu theksoi që ndërsa rekomandimet e PKDNJ-së për PSSP-në janë të një natyre këshilluese "ne jemi të shqetësuar që këshilla e Panelit nuk është marrë parasysh apo implementuar në praktikë. Amnesty International është jashtëzakonisht i shqetësuar që, si pasojë, viktimave të këtyre shkeljeve vazhdohet t'u mohohet e drejta për mjet efektiv juridik, siç është vendosur në standardet e aplikueshme ndërkombëtare dhe rajonale në Kosovë …"

---

[7] *Lajmet 'online' (Vesti online)*, 11 dhjetor 2015, "Unmik zataškao zločine OVK" (*UNMIK-u fshehu krimet e UÇK-së*), http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/538812/Unmik-zataskao-zlocine-OVK

34. Duke iu kthyer çështjes së kompensimit për viktimat në rastet e PZHV-e, siç rekomandohet nga Paneli, AI theksoi që "në raportin e tij të gushtit për Sekretarin e Përgjithshëm, PSSP-ja rekomandoi publikisht 'vazhdimin e kërkimit për një mjet për të kompensuar familjet'." AI po ashtu e pyeti PSSP-në për atë se "çfarë masash janë eksploruar me qëllim zgjidhjen e kësaj çështjeje që ka vazhduar për një kohë të gjatë nga korriku i vitit 2015, kur në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm po ashtu thuhet se 'asnjë progres [nuk] është bërë në lidhje me rekomandimet e Panelit në lidhje me pagesën e kompensimit adekuat për dëmet morale që ishin shkaktuar si rezultat i atyre shkeljeve."[8] Në kohën e fundit, pas një udhëtimi në Selinë e Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork, PSSP-ja e informoi Sekretariatin e Panelit se ai kishte pasur shumë diskutime në Nju Jork në lidhje me çështjen e kompensimit për familjet. Megjithatë, Paneli nuk është në dijeni për ndonjë zhvillim tjetër lidhur me këtë çështje.

35. Përveç kësaj, në vitin 2015, Koha Ditore, gazetë në gjuhën shqipe që botohet në Kosovë, paraqiti një përmbledhje të mendimit të Panelit në rastin *Balaj dhe të tjerët*. Gazeta thekson se "kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, tha që vendimi i Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ) për të vërtetuar përgjegjësinë e UNMIK-ut gjatë protestës së Vetëvendosjes në vitin 2007 ku dy protestues, Mon Balaj dhe Arben Xheladini, ishin vrarë, paraqet lajm të mirë. Ahmeti tha se pikëllimi i familjeve të viktimave nuk do të largohet por ata do të jenë më të qetë duke ditur se drejtësia ka fituar. Ahmeti sqaroi se tre gjykatës të PKDNJ-së konfirmuan që Policia e UNMIK-ut shkeli rregulloret dhe të drejtat e njeriut gjatë protestës. PKDNJ po ashtu i bëri thirrje UNMIK-ut t'iu kërkojë falje familjeve të viktimave dhe të marrë përsipër përgjegjësinë për këto akte."[9]

36. Në vitin 2016, kishte një mbulim të gjerë ndërkombëtar dhe lokal të mendimit të Panelit në rastin *N.M. dhe të tjerët*, lidhur me pretendimet për helmim nga plumbi dhe problemet tjera shëndetësore për shkak se UNMIK-u i vendosi pjesëtarët e komunitetit RAE në kampe të kontaminuara në Kosovën veriore për shumë vjet. Rasti është mbuluar nga the New York Times, *Vesti*, *Politika*, Al Jazeera, Prishtina Insight, dhe në faqet e ndryshme të internetit për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Human Rights Watch dhe Oxford Human Rights Hub.[10]

4. Ngarkesa me lëndë e Panelit

4.1 Statistikat

---

[8] Letër e Amnesty International drejtuar PSSP-së Dr Zahir Tanin, 22 shkurt 2016, "Qasja në drejtësi për viktimat e UÇK-së".

[9] Koha Ditore, 4 mars 2015, "Ahmeti: Vërtetimi i përgjegjësisë së UNMIK-ut për vrasjen e Balajt e Xheladinit, lajm i mirë" (Ahmeti: Confirmation of UNMIK responsibility for killing the Xheladini Balaj, good news)

http://koha.net/?id=&l=47249

[10] New York Times, 7 prill 2016 "Romët e helmuar në kampet e OKB-së në Kosovë mund të marrin kërkimfalje dhe kompensim"

http://www.nytimes.com/2016/04/08/world/europe/roma-poisoned-at-un-camps-in-kosovo-may-get-apology-and-compensation.html?_r=3#whats-next

37. Gjatë vitit 2015, Paneli miratoi 45 mendime mbi bazueshmërinë (në lidhje me 79 ankesa). Më pas, nga janari i vitit 2016 deri në fund të majit të vitit 2016, Paneli e solli ngarkesën e vet me lëndë në 9 ankesa, të cilat mbetën në zhvillim e sipër në fund të vitit 2015, duke miratuar 6 mendime mbi bazueshmërinë e tyre. Paneli po ashtu hodhi poshtë një kërkesë për rishikim të një mendimi të mëparshëm lidhur me 17 raste (në rastin *Kostiq dhe të tjerët*, 111/09 et all).[11]

4.2 Mendimet e Panelit të përzgjedhura sipas lëndës

38. Më poshtë janë një numër i mendimeve të dhëna në vitin 2015, të cekura sipas lëndës dhe të cilat janë vënë në pah për diskutim të mëtejmë në pjesën 5 të këtij raporti:

E drejta në jetë (esenciale dhe procedurale) – e drejta për hetim efektiv - e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues – e drejta për tubim paqësor
- *Kadri Balaj dhe të tjerët*, 04/07 (mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015)

E drejta në jetë (esenciale) – e drejta në strehim adekuat – e drejta në shëndet- e drejta në standard adekuat të jetesës
- *N.M dhe të tjerët*, 26/08 (mendimi i 26 shkurtit të vitit 2016)

E drejta në jetë (procedurale) – e drejta për hetim efektiv
- *Mira Bullatoviq*, 275/09 (mendimi i 22 prillit të vitit 2015)
- *S.C. dhe të tjerët*, 13/09 dhe të tjerët (mendimi i 22 prillit të vitit 2015)
- *Budimirka Miriq dhe të tjerët*, 68/09 dhe të tjerët (mendimi i 10 shtatorit të vitit 2015)
- *Zhaklina Mishlen dhe të tjerët*, 58/09 dhe të tjerët (mendimi i 13 nëntorit të vitit 2015)

E drejta në jetë (procedurale) – e drejta për hetim efektiv- e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues
- *Ranko Milenkoviq*, 255/09 (mendimi i 26 qershorit të vitit 2015)

E drejta në jetë (procedurale) – e drejta për hetim efektiv – e drejta në jetë familjare
- *Petar Joviçiq*, 233/09 (mendimi i 24 qershorit të vitit 2015)

E drejta në jetë (procedurale) – e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues - e drejta për hetim efektiv – të drejtat sipas KEDKG-së
- *S.M.*, 342/09 (mendimi i 18 marsit të vitit 2016)

E drejta në liri- e drejta për hetim efektiv
- *Bogolub Kostiq dhe të tjerët*, 111/09 dhe të tjerët (mendimi i 23 tetorit të vitit 2015)

E drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues – e drejta në sigurim social dhe standard adekuat të jetesës
- *B.K.*, 85/10 (mendimi i 13 nëntorit të vitit 2015)
- *Tomë Krasniqi*, 08/10 (mendimi i 17 majit të vitit 2016)

[11] Për statistika të detajuara, shih Aneksin C.

E drejta në sigurim social – e **drejta në standard adekuat të jetesës – e drejta për qasje në gjykatë- e drejta për mjet efektiv juridik**

- *Punëtorët e Minierave Kishnicë dhe Novobërdë të Kombinatit Trepça*, 81/10 (mendimi i 18 majit të vitit 2016)

E drejta për të qenë i lirë nga dhuna e bazuar në gjini

- *S.M.*, 342/09 (mendimi i 18 marsit të vitit 2016)

5. Jurisprudenca e Panelit

39. Gjatë seancës së vet të majit të vitit 2016, Paneli përfundoi punën e vet në raste. Për të mbyllur dy rastet e fundit që ishin në listën e vet të çështjeve gjyqësore, Paneli mori vendime dhe dha opinione që dhanë një shkallë të përfundimit ankuesve ndërsa në të njëjtën kohë zgjeroi jurisprudencën e Panelit në një numër çështjesh të reja procedurale dhe esenciale. Vendimet dhe mendimet më të rëndësishme të Panelit nga janari i vitit 2015 deri në maj të vitit 2016 përshkruhen në më shumë detaje më poshtë.

5.1 E drejta në jetë – E drejta për hetim efektiv – E drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues – E drejta për tubim paqësor

40. Në rastin *Balaj dhe të tjerët*, ankuesit u ankuan se Policia e UNMIK-ut përdori forcë të tepruar gjatë një operacioni për kontroll të turmës në Kosovë më 17 shkurt 2007, që rezultoi me vdekjet e dy viktimave dhe plagosjen e rëndë të dy viktimave tjera. Së pari, Paneli vendosi që pjesa esenciale e nenit 2 të KEDNJ-së ishte plotësisht e aplikueshme në këtë situatë.

41. Paneli po ashtu theksoi që "[n]uk vihet në diskutim në këtë rast të veçantë se Policia e UNMIK-ut përdori forcë të tepruar për të shpërndarë demonstratën, dështoi të ushtrojë kontroll të duhur ndaj municionit dhe po ashtu dështoi të sigurojë se oficerët ishin trajnuar në mënyrë adekuate dhe se kishin marrë urdhra të qarta. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, forca e përdorur nuk ishte absolutisht e nevojshme në kuadër të kuptimit të nenit 2(2) dhe tërësia e këtyre dështimeve përbën shkelje të obligimit esencial të nenit 2 të KEDNJ-së.

42. Lidhur me obligimin procedural të nenit 2, Paneli theksoi se hetimi ishte filluar dhe veprimet fillestare ishin bërë në kohën e duhur. Paneli po ashtu gjeti që veprimet e Policisë së UNMIK-ut dhe prokurorit special ishin mjaftueshëm të shpejta dhe të plota për të përmbushur kërkesat e nenit 2 të KEDNJ-së. Megjithatë, vonesa në marrjen në pyetje të oficerëve të Policisë së UNMIK-ut të cilët morën pjesë në operacion, për të cilën nuk është dhënë asnjë sqarim nga prokurori special, dhe fakti që nuk ishin marrë hapat e duhur për të zvogëluar rrezikun e ushtrimit të ndikimit të fshehtë sa i përket dëshmisë e vunë në rrezik, sipas mendimit të Panelit, të qenit adekuat të hetimit.

43. Për sa i përket pavarësisë së hetimit, Paneli po ashtu theksoi që "hetimi ishte kryer fillimisht nga Njësiti Rajonal për Hetim i Prishtinës me përkrahjen e nevojshme nga Zyra e Qarkut e Prokurorisë Publike në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Megjithëse hetimi ishte kryer nën udhëheqjen e përgjithshme të një prokurori ndërkombëtar, i gjithë hetimi ishte

hequr nga juridiksioni vendor dhe i ishte dhënë një prokurori special, duke mos u ndjekur vetë rregullat e UNMIK-ut që kanë të bëjnë me caktimin e hetimeve prokurorëve dhe gjykatësve ndërkombëtarë. Megjithëse kjo do të mund ta sqaronte disi pretendimin e ankuesve se hetimi nuk ishte i pavarur, Paneli nuk mundi të shquante ndonjë të metë në hetim nga prokurori special e cila do të tregonte për mungesë të pavarësisë. Megjithatë, Paneli theksoi me shqetësim pjesëmarrjen e oficerëve rumunë të Policisë së UNMIK-ut në hetim, megjithëse dyshim kryesor ishin të shtënat vdekjeprurëse që erdhën nga policia rumune. Kjo ndodhi përkundër faktit që "Task Forca hetimore (Grup i veçantë hetimor) nuk përfshiu zyrtarisht ndonjë oficer rumun, e as që prokurori special përmendi pjesëmarrjen e tyre në raportet e tij" dhe që "[P]SSP-ja konfirmoi se asnjë oficer i Policisë së UNMIK-ut i nacionalitetit rumun nuk ishte pjesëtar i Task Forcës por që 'hetuesve u ishte kërkuar të shfrytëzojnë përkthyesit rumunë'". Duke marrë parasysh, po ashtu, rrethanat tjera, Paneli përfundoi se situata nuk ofroi garanci të mjaftueshme për të përjashtuar ndonjë dyshim legjitim lidhur me pavarësinë dhe paanësinë e hetimit.

44. Veç kësaj, Paneli po ashtu konstatoi se hetimi nuk ishte i hapur për shqyrtim publik dhe se nuk kishte shqyrtim të rregullt të procesit. "Duke marrë parasysh të metat e përmendura më lart Paneli konstaton se hetimi nuk dha garanci të mjaftueshme të pavarësisë dhe paanësisë, siç përshkruhet me nenin 2 të KEDNJ-së."

45. Për sa i përket përpikërisë së hetimit, Paneli theksoi që hetimi zbuloi shumë fakte dhe pista, por dështoi të ndjek me përpikëri shumicën e tyre. Për shembull, ishte vërtetuar se plumbat e gomës ishin me afat të skaduar për 10 vjet dhe nuk është dashur madje as të sillen në Kosovë, kur Njësia Speciale e Policisë Rumune arriti apo është dashur të largohen gjatë inspektimeve të rregullta të armëve (dy herë në vjet). Megjithatë, nuk është bërë asnjë hetim se si kishin mbetur ata në rafte dhe përfunduan në armët e mbushura dhe vranë/plagosën njerëz. Nuk është nxjerrë asnjë përfundim për përgjegjësinë e mundshme penale individuale të atyre të cilët, me veprimin apo mosveprimin e tyre, e lejuan këtë të ndodhë. Prandaj, Paneli konsideroi se hetimi i kryer në këtë rast nuk përmbushi kërkesat sa i përket përpikërisë, siç kërkohet me nenin 2 të KEDNJ-së.

46. Në fund, Paneli po ashtu theksoi që hetimi për shkelje të mundshme të urdhrave administrativë dhe standardeve të aplikueshme është një pjesë e pandashme e obligimit procedural me qëllim të shmangies së pandëshkueshmërisë. Ky element, dhe veçanërisht hetimi disiplinor, bëhet veçanërisht i rëndësishëm në situatën, kur, si në rastin aktual, hetimi nuk ishte në gjendje ta provojë përgjegjësinë individuale penale. Prandaj, Paneli shpreh shqetësimin e vet për mungesën e informatave për ndonjë procedurë disiplinore kundër atyre që ishin përgjegjës për dështimet e mëdha administrative dhe organizative siç identifikohen nga prokurori special.

47. Paneli përfundoi "[n]ë përmbledhje që, të metat dhe mangësitë e përshkruara më lart ngritin arsye serioze të dyshohet nëse hetimi ishte në gjendje t'i gjejë ata që ishin përgjegjës dhe t'i sjellë para drejtësisë. Prandaj, Paneli përfundon se UNMIK-u dështoi të kryejë hetim efektiv për vrasjen e z. Mon Balaj dhe z. Arben Xheladini dhe plagosjen e rëndë të z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj. Prandaj, ka pasur një shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, obligimi procedural."

48. Për sa i përket pretendimit që UNMIK-u ra ndesh me të drejtën e ankuesve për tubim paqësor në një mënyrë që ishte e pajustifikueshme dhe qartas joproporcionale, Paneli së pari rikujton se PSSP-ja i pranoi plotësisht dhe qëndroi prapa përfundimeve të prokurorit special të paraqitura në raportin e tij mbi çështjen. Paneli bëri një citim nga raporti i tij, në të cilin thuhej, "[g] jatë rrjedhës së demonstratës protestuesit hodhën objekte mbi policinë dhe iu vërsulën njësiteve të SHPK-së që kishin bllokuar rrugën "Nënë Tereza" ndërsa i afroheshin ndërtesës së Qeverisë. Policia zbrazi bombolat me gaz lotsjellës dhe pastaj avancoi poshtë rrugës "Nënë Tereza" ku ndodhën përleshje të tjera. Lëndime pësuan policia dhe protestuesit."

49. Më tutje, Paneli theksoi që "ankuesit morën pjesë në demonstratë me qëllimin për të protestuar kundër Planit të Ahtisaarit, një propozim i pranuar nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe UNMIK-u, i cili ishte i rëndësishëm për të ardhmen e Krahinës. Sipas mendimit të Panelit, qëllimi që autoritetet e UNMIK-ut e kishin ndaj ngjarjeve publike të organizuara nga Lëvizja Vetëvendosje, që u materializua përmes interferencës në demonstratë dhe forcës së përdorur nga policia për t'i shpërndarë pjesëmarrësit (Policia e UNMIK-ut "shënonte progres' ndaj demonstruesve), ishte i dizajnuar të ketë "efekt trishtues" dhe t'i dekurajojë pjesëmarrësit që të marrin pjesë në takime të ngjashme."

50. Paneli po ashtu rikujtoi që "autoritetet e kanë për detyrë të marrin masa të duhura për sa i përket demonstratave të ligjshme me qëllim të sigurimit të drejtimit të tyre paqësor dhe sigurisë së të gjithë qytetarëve. Paneli vërejti që në kohën në fjalë legjislacioni i aplikueshëm nuk kërkonte një autorizim zyrtar nga autoritetet për mbajtjen e demonstratave publike; por organizatorët ishin të obliguar t'i njoftojnë autoritetet (policinë dhe komunën) 48 orë para ngjarjes (Neni 3, Ligji mbi Tubimin Publik). Në lidhje me këtë, Paneli rikujton qëndrimin e Gjykatës Evropiane, i cili konfirmon se është e rëndësishme që asociacionet dhe të tjerët që organizojnë demonstrata, si aktorë në proces demokratik, t'i respektojnë rregullat që rregullojnë atë proces duke u pajtuar me rregulloret në fuqi. Në këtë rast të veçantë, nuk është paraqitur asnjë njoftim zyrtar. Megjithatë, Vetëvendosje në disa raste ka njoftuar publikisht për demonstratën; më 29 janar 2007, një buletin në lidhje me atë gjithashtu është publikuar nga Lëvizja." Paneli po ashtu theksoi se negocimi dhe/apo ndërmjetësimi mund të jenë të dobishme që të mos eskalojë konflikti. Në këtë rast, Paneli nuk pa ndonjë indikacion të një përpjekjeje të udhëheqjes së Vetëvendosjes që të bisedojë me Policinë e UNMIK-ut.

51. Përveç kësaj, Paneli theksoi që "policia duhet të përdorë mjete më të rrezikshme të reagimit vetëm kur ato më pak të rrezikshmet janë provuar të jenë joefektive, pas një vijimësie të përdorimit të forcës. Megjithatë, "e tillë nuk ishte situata në terren më 10 shkurt 2007, ku disa policë bënë të kundërtën. Atë ditë, menjëherë pasi një grup shumë i vogël i protestuesve të paarmatosur (rreth 10 persona) provuan të kalojnë përmes kordonit policor, autoritetet intervenuan me shpejtësi me forcë të konsiderueshme me qëllim të shpërndarjes të krejt demonstratës, kur bombola me gaz lotsjellës dhe plumba gome ishin gjuajtur pa diskriminim në turmë, duke goditur dhe lënduar protestuesit pa menduar për jetët e tyre dhe sigurinë; ndërsa shumica nga ta nuk po provonin të bëjnë diçka të dhunshme kundër policisë. Për më tepër, lëndimet e policëve ishin tepër të vogla, pasi shumica nga ta kishin

‘pajisjen e plotë KTT’. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, megjithëse ka pasur ca dhunë, niveli i rrezikut për policët ishte i ulët.”

52. Paneli konsideroi se në rastin aktual intervenimi me forcë i policëve ishte joproporcional dhe jo i nevojshëm në një shoqëri demokratike për parandalimin e trazirës në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 11 të Konventës Evropiane. “Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Paneli konstaton se ka pasur shkelje të nenit 11 të KEDNJ-së” (shih PKDNJ, *Balaj dhe të tjerët*, lënda nr. 04/07, mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015, §§ 188-190, 202-221, 248-268).

5.2 E drejta në jetë – e drejta për hetim efektiv - neni 2 i KEDNJ-së

Mungesa e hetimit efektiv-Nuk ka asnjë të dhënë për veprim esencial të ndërmarrë nga UNMIK-u –Juridiksioni i TNPJ-së nuk është absolut

53. Në rastin *Bullatoviq*, ankuesja u ankua se tre pjesëtarë të armatosur të UÇK-së në rroba civile hynë në vagonin e udhëtarëve në të cilin ishin ankuesja dhe burri i saj, e identifikuan z.Ivan Bullatoviq dhe e zbritën nga treni; që nga ajo kohë vendndodhja e tij është e panjohur, pa hetim efektiv të krimeve nga UNMIK-u. Paneli theksoi “pohimin e PSSP-së se mungesa e veprimit të Policisë së UNMIK-ut në lidhje me këtë hetim mund t’i atribuohet një hetimi të TNPJ-së për çështjen**.** Në fillim, Paneli thekson se nuk e konteston primatin e përgjithshëm të TNPJ-së, sa i përket juridiksionit për të hetuar çdo krim brenda juridiksionit të vet të kryer në territorin e ish-Jugosllavisë, për shkak të statusit të vet të njohur ndërkombëtar sipas Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 827 (1993).” Megjithatë, Paneli po ashtu theksoi se “’primati’ i juridiksionit të TNPJ-së nuk është absolut.”

54. Gjatë shqyrtimit të dosjes hetimore, Paneli theksoi që “një kërkesë formale për informata dhe bashkëpunim apo një kërkesë për dorëzim të rasteve duhet t’u paraqitet autoriteteve nacionale nga TNPJ-ja. Pra, TNPJ-ja duhet paraqitur një kërkesë të tillë UNMIK-ut, para se ta marrë përsipër rastin, e cila do të pasqyrohej zyrtarisht në dokumentacionin e UNMIK-ut. Kjo, e para, do të arsyetonte mungesën e veprimit të autoriteteve të UNMIK-ut në lidhje me hetimet e veçanta, dhe, e dyta, do të mundësonte përcjelljen dhe marrjen në të ardhmen të dokumenteve hetimore nga ana e autoriteteve nacionale, kur është e nevojshme… Megjithatë, asnjë e dhënë për kërkesë zyrtare të natyrës së tillë nuk gjendet në dosje … Paneli po ashtu thekson në lidhje me këtë se autoriteti hetimor duhet gjithmonë të jetë i përcaktuar qartë; në rast se ndodh marrja përsipër e një rasti nga autoriteti tjetër, dosja duhet të ketë të dhëna të qarta për këtë. Situata në këtë rast, siç i është paraqitur Panelit, është se çështja është hetuar nga Policia e UNMIK-ut dhe sipas PSSP-së kishte një hetim të zhvilluar nga TNPJ-**ja**. Sipas mendimit të Panelit, një situatë e tillë nuk duhet lejuar të ndodhë, pasi ajo krijon konfuzion se cili autoritet ishte përgjegjës për hetim, dhe kështu vetvetiu paraqet një problem sipas nenit 2” (shih PKDNJ, *Bullatoviq*, lënda nr. 275/09, mendimi i 22 prillit të vitit 2015, §§ 137-143).

Nuk ka shkelje për shkak se TNPJ-a e ka marrë përsipër hetimin për zhdukjen dhe vrasjen masive

55. Në rastin *S.C. dhe të tjerët*, në ankesë pretendohet që UNMIK-u dështoi të bëjë hetim efektiv për zhdukjen e z. B.C. dhe dy ushtarëve të Armatës jugosllave, të cilët së bashku me dy ushtarë tjerë jugosllavë, ishin sulmuar dhe rrëmbyer nga një furgon në të cilin po udhëtonin në *rrugën* nga Prizreni për në Prishtinë. Gjatë shqyrtimit të dosjes hetimore Paneli theksoi që "[n]ë këto rrethana, Paneli mund ta pranojë pohimin e PSSP-së se Policia e UNMIK-ut bëri përpjekje hetimore substanciale dhe gjithëpërfshirëse në pajtim me nenin 2 përkatësisht kërkesat procedurale për të përcaktuar të dyja vendndodhjen dhe fatin e viktimave, duke përfshirë: '[n]dërlidhjen me autoritetet serbe me qëllim të identifikimit të viktimave dhe të dyshuarve në fotografi; [k]ërkimin dhe marrjen e analizës së mjekësisë ligjore dhe të ekspertëve për dëshminë...[k]ërkimin e informatave nga burimet e tjera ndërkombëtare dhe joqeveritare; dhe kryerjen e dy zhvarrimeve; [k]ryerjen e hulumtimit të gjerë mbi incidentet ushtarake në kohën që [viktimat] janë zhdukur; [k]ontaktimin e ish-komandantëve ushtarakë; dhe [i]ntervistimin e disa dëshmitarëve'. Paneli thekson se dosja dëshmon që prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut luajtën një rol integral në ndjekjen e pistave hetimore … Duke marrë krejt këtë parasysh, Paneli konsideron se vëllimi i madh i aktivitetit të ndërmarrë nga Policia e UNMIK-ut, veçanërisht gjatë periudhës nën juridiksion të Panelit, përmban cilësi të një hetimi efektiv" (shih PKDNJ, *S.C. dhe të tjerët*, lëndët nr. 13/09 dhe të tjerët, mendimi i 22 prillit të vitit 2015, §§ 143-144).

<u>Dështimi për të ndjekur pista të qarta hetimore pas një sulmi të orkestruar të UÇK-së në një fshat</u>

56. Në rastin *Miriq dhe të tjerët*, ankuesit u ankuan se anëtarët e tyre të familjes, duke përfshirë katër anëtarë mbi moshën e pensionimit, janë rrëmbyer nga fshati Dojnicë, Komuna e Prizrenit në qershor të vitit 1999 gjatë një sulmi të orkestruar të pjesëtarëve të UÇK-së dhe më pas UNMIK-u nuk kreu hetim efektiv për krimet. Paneli e krahasoi rastin, me rastin e vet të mëparshëm *Mitiq dhe të tjerët*, ku Paneli përfundoi që asnjë përpjekje substanciale nuk është bërë nga autoritetet hetimore të UNMIK-ut për të hetuar në një mënyrë sistematike dhe të koordinuar zhdukjen e mbi 20 personave nga fshati Dojnicë, në qershor të vitit 1999, gjatë një aksioni të bashkërenduar nga UÇK-ja, i cili i duket Panelit të jetë një operacion i pastrimit etnik. Paneli theksoi se ngjashëm në këtë rast "asnjë përpjekje nuk është bërë nga Policia e UNMIK-ut për të ndjekur një pistë të qartë të hetimit që çonte te grupi i UÇK-së që kontrollonte Dojnicën dhe fshatrat në afërsi, i cili në deklaratat e dëshmitarëve përmendej të ishte implikuar në krime kundër banorëve civilë të zonës. Paneli, po ashtu, e ka regjistruar në të dhëna se kjo nuk është hera e parë që ai sheh dështimin për t'i hetuar rrëmbimet në shkallë të lartë të banorëve serbë të Kosovës në rajonin e Prizrenit në Kosovë, që veçanërisht kishin në shënjestër personat e moshuar si disa nga personat më të cenueshëm. Mungesa e qartë e një reagimi të menjëhershëm dhe koheziv të UNMIK-ut, mund t'u ketë dërguar sinjalin autorëve që, autoritetet ose nuk ishin në gjendje apo nuk ishin të gatshme t'i hetojnë veprat e tilla penale. Një qëndrim i tillë i autoriteteve ndaj krimeve më të rënda në ndonjë shoqëri, dhe veçanërisht në rrethanat pas konfliktit, krijon pashmangshëm një kulturë të mosndëshkimit ndër kriminelët dhe mund të çojë vetëm në përkeqësim të situatës. Problemet të cilat UNMIK-u i hasi në fillim të misionit të vet, të cilat u cekën më lart, nuk arsyetojnë mosveprimin e tillë, as në fillim e as më vonë" (shih PKDNJ, *Miriq dhe të tjerët*, lëndët nr. 68/09 dhe të tjerët, mendimi i 10 shtatorit të vitit 2015, §§ 204-206).

<u>Dështime për një kohë të gjatë të Policisë së UNMIK-ut për t'i lidhur hetimet</u>

57. Në rastin *Mishlen dhe të tjerët*, ankuesit u ankuan se anëtarët e tyre të familjes janë zhdukur në rajonin e Pejës më 19 qershor 1999 derisa ishin duke udhëtuar me veturë nga Beogradi për në Pejë dhe se UNMIK-u nuk kreu hetim efektiv për krimet. Gjatë shqyrtimit të dosjes hetimore Paneli theksoi që "[s]ipas fjalëve të PSSP-së, ishte imperativ për Policinë e UNMIK-ut të krijojë rend dhe të ndërtojë shpejt një kornizë për t'i regjistruar dhe hetuar krimet. Paneli pajtohet me PSSP-në. Megjithatë, me gjithë shumëllojshmërinë e informatave në dispozicion të autoriteteve të UNMIK-ut për këtë rast, nuk është kryer asnjë hetim i arsyeshëm. Paneli këtë e kupton si tregues se ky obligim nuk përmbushet thjesht me krijimin e një kornize adekuate, por vetëm kur korniza bëhet një sistem i koordinuar si duhet që është në gjendje të kryejë hetim adekuat dhe efektiv në pajtim me nenin 2 të KEDNJ-së. Në këtë rast të veçantë, dështimi për një kohë të gjatë i NJPZH-së së Policisë së UNMIK-ut dhe NJHKL-së për t'i lidhur rastet (deri në vitin 2005) flet vetvetiu" (shih PKDNJ, *Mishlen dhe të tjerët*, lëndët nr. 58/09 dhe të tjerët, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2015, § 175).

5.3 E drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues - Neni 3 i KEDNJ-së

<u>Vonesa për 15 vjet e Policisë së UNMIK-ut për t'i kthyer mbetjet mortore të anëtarit të familjes u shkaktoi vuajtje të madhe ankuesve</u>

58. Në rastin *Milenkoviq*, i cili kishte të bënte me pretendimin e ankuesit se UNMIK-u nuk kreu hetim efektiv për zhdukjen dhe vrasjen e vëllait të tij dhe po ashtu nuk e informoi atë për gjendjen e hetimit të vet, Paneli së pari shqyrtoi dosjen hetimore, duke theksuar që "[k] ontakti i fundit i regjistruar në mes familjes së z. Rajko Milenkoviq dhe autoriteteve të UNMIK-ut ishte në janar të vitit 2002 … Ndodhi vetëm në tetor të vitit 2014, që është pesëmbëdhjetë vjet pas zhdukjes së z. Rajko Milenkoviq, që mbetjet e tij mortore të kthehen përfundimisht për të pushuar përgjithmonë dhe që familja t'i pranojë dokumentet e nevojshme…[V] onesa e gjatë është shkaktuar nga një gabim i ZPZHML-së, e cila ishte nën autoritetin e UNMIK-ut. Sipas mendimit të Panelit, UNMIK-u është dashur ta informojë familjen për identifikimin e mbetjeve mortore të z. Rajko Milenkoviq, dhe kështu të sigurojë që ata të mos vuajnë më gjatë për mungesë të informatave rreth fatit të tij, dhe t'ua dorëzojë dokumentet e nevojshme për identifikim. Veç kësaj, për sa i përket humbjes së trupit, UNMIK-u është dashur t'ua sqaronte situatën ankuesit dhe familjes së tij, t'u kërkonte falje atyre për gabimin dhe t'i siguronte ata se ai do të korrigjohej sa më shpejt që të jetë e mundshme. Familja është dashur të informohej rregullisht pas kësaj për ndonjë progres në këtë drejtim."

59. "Megjithatë", Paneli theksoi, "autoritetet e UNMIK-ut zgjodhën në ato rrethana rrugën më të dhimbshme për të trajtuar familjen – përmes heshtjes, duke mos i informuar kurrë ata që fakti i vdekjes së z. Rajko Milenkoviq ishte vërtetuar pozitivisht. Në fakt, vëllai i ankuesit "u zhduk" për herë të dytë vetëm për shkak të mungesës së vëmendjes së UNMIK-ut, duke e shtuar kështu dhimbjen tashmë të përjetuar nga anëtarët e tij të familjes. Së paku dy nga më të afërmit e z. Rajko Milenkoviq, gruaja e tij dhe vëllai i tij, vdiqën para se ata të pranonin konfirmimin për fatin e tij. Sipas mendimit të Panelit, vuajtje veçanërisht e rëndë i

ishte shkaktuar familjes nga koha që ata u vunë në dijeni për një identifikim të mundshëm, në nëntor të vitit 2000 dhe për një nevojë të mundshme për rizhvarrim, pas të cilave ata nuk pranuan asnjë informatë tjetër deri te dorëzimi i mbetjeve mortore të z. Rajko Milenkoviq në vitin 2014."

60. Paneli e merr parasysh "faktin se tashmë në mars të vitit 2002, një zyrtar i NJPZH-së theksoi se 'familja e z. Rajko Milenkoviq nuk ishte e kënaqur me mënyrën se si ata janë trajtuar … Unë sugjeroj fuqishëm që një takim me familjen të mbahet së shpejti, kryesisht për shkak të trajtimit të keq që ata e kanë pasur. Kështu që do të ishte mirë nëse pak besim u kthehet atyre nga UNMIK-u'. Megjithatë, asnjë kontakt me familjen, madje as një për mirësjellje, duket se nuk ka pasur. Veç kësaj, në situatën ku gjetja e varrit të z. Rajko Milenkoviq dhe rrethanat e varrimit të tij ishin të panjohura, Paneli nuk mund ta pranojë deklaratën e PSSP-së se mbetjet e tij mortore 'ishin varrosur me dinjitet dhe respekt nga UNMIK-u.' "

61. Paneli përfundoi që "ankuesi dhe familja e tij përjetuan shqetësim të rëndë dhe dhimbje për një periudhë kohore të zgjatur, një pjesë e konsiderueshme e së cilës bie nën juridiksionin e përkohshëm të Panelit, nga mënyra se si autoritetet e UNMIK-ut e kanë trajtuar rastin dhe si rezultat i pamundësisë së tyre të zbulojnë se çfarë ka ndodhur me mbetjet mortore të z. Rajko Milenkoviq. Në lidhje me këtë, është e qartë se, dhimbja që u është shkaktuar ankuesit dhe familjes së tij, të cilët duhej të jetojnë në pasiguri rreth fatit të z. Rajko Milenkoviq, është e padurueshme" (shih PKDNJ, *Milenkoviq*, lënda nr. 255/09, mendimi i 26 qershorit të vitit 2015, §§ 201-204).

<u>Nuk ka asnjë dëshmi se UNMIK-u ishte në dijeni për zhvendosjen e mbetjeve mortore</u>

62. Në rastin tjetër, *Joviçiq*, ankuesi u ankua që dështimi i UNMIK-ut që të informojë si duhet atë rreth vdekjes së gruas së tij dhe rreth zhvendosjes së mbetjeve të saj mortore, i shkaktoi atij dhimbje dhe vuajtje. Në mënyrë specifike, derisa ankuesi ishte detyruar të largohet nga Kosova për shkaqe sigurie, gruaja e ankuesit, znj. Alinoviq, ishte dërguar në Spitalin e Prizrenit në mars të vitit 1999, dhe kishte vdekur nga shkaqet natyrore në Spitalin e Prizrenit, më 8 gusht 1999 pa e ditur burri i saj. Megjithatë, në konfuzion, ajo me sa duket ishte vënë në listë si e zhdukur nga KNKK-ja. Më pas, trupi i saj ishte varrosur në varrezat e qytetit të Prizrenit, por që vendi i saktë i varrit të saj në atë varrezë nuk ishte i njohur. Dikur më vonë, ishte kryer në atë varrezë së paku një zhvarrim i një numri të mbetjeve mortore, të dyshuara të jenë ato të banorëve të paidentifikuar lokalë serbë, të cilët ishin vrarë menjëherë pas arritjes së KFOR-it dhe UNMIK-ut në Prizren dhe në zonën e afërt. Ankuesi bëri shumë përpjekje pas kësaj të gjejë mbetjet mortore të gruas së tij, duke përfshirë vizitën në varrezat e qytetit të Prizrenit dhe pyetur stafin, por nuk ishte në gjendje ta gjejë se ku ajo ishte varrosur.

63. Pas shqyrtimit të dosjes, Paneli theksoi që "[m]egjithëse nuk ka asnjë dyshim se znj. Krasenka Alinoviq kishte vdekur nga shkaqet natyrore, akoma mund të ketë një obligim nga ana e autoriteteve për të hetuar çështjen, ngjashëm me atë për zhdukjet sipas nenit 2 të KEDNJ-së (e drejta në jetë, pjesa procedurale). Megjithatë, përgjegjësia e tillë do të ekzistonte sapo çështja të arrinte në vëmendjen e tyre. Paneli ka konstatuar në një numër rastesh se autoritetet e UNMIK-ut ishin të obliguara t'i hetojnë zhdukjet nga koha që ato

ishin vënë në dijeni për pretendimet e tilla. Paneli, po ashtu, i ka marrë parasysh njoftimet për zhdukjet të KNKK-së për UNMIK-un të jenë të mjaftueshme për të krijuar obligim për të hetuar sipas nenit 2. Në lidhje me këtë, Paneli e pranon se dosja para tij përfshinë një dokument që konfirmon se kishte një rast të hapur nga NJPZH-ja, me sa duket në vitin 2003, në lidhje me znj. Krasenka Alinoviq. Paneli thekson se dosja e NJPZH-së përmban certifikatën e vdekjes që konfirmon se ajo vdiq nga shkaqet natyrore dhe rrjedhimisht tregonte se nuk ishte shkaktuar nga një akt kriminal."

64. Paneli po ashtu theksoi që "Panelit i duket se NJPZH, bazuar në informatat në dispozicion të tyre, e kishte kualifikuar fillimisht rastin e znj. Krasenka Alinoviq si vrasje e mundshme dhe/apo zhdukje. Megjithatë, me konfirmimin se ajo në fakt vdiq nga shkaqe natyrore dhe më pas ishte varrosur në varrezat e Prizrenit, dhe për shkak të mandatit të vet specifik, NJPZH mund të ndërpriste hetimin e vet pasi nuk kishte asnjë dyshim për sa i përket fatit të saj …Megjithatë, ankuesi nuk ka pohuar se ai ka kontaktuar ndonjë autoritet të UNMIK-ut për t'i informuar ata për situatën dhe t'u kërkojë atyre që të japin sqarim rreth gjetjes së mbetjeve mortore të gruas së tij…dhe dosja nuk përmban asnjë indikacion se në rastin aktual autoritetet e UNMIK-ut u informuan ndonjëherë apo ishin vënë në dijeni për zhdukjen e supozuar të mbetjeve mortore të znj. Krasenka Alinoviq dhe që iu kërkua t'i gjejnë ato. Paneli shpreh keqardhje që ankuesi deri më tani nuk ka qenë gjendje ta gjejë vendin ku pushon përfundimisht gruaja e tij, e cila padyshim i shkaktoi atij dhimbje dhe vuajtje. Megjithatë, në rrethanat e përshkruara Paneli nuk është bindur se me sjelljen e tyre autoritetet e UNMIK-ut i shkaktuan apo në çfarëdo mënyre i kontribuuan shqetësimit mental të parashtruesit në lidhje me vdekjen dhe më pas zhdukjen e supozuar të mbetjeve mortore të znj. Krasenka Alinoviq." Prandaj, Paneli konstatoi se UNMIK-u nuk kishte bërë shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së.

65. Për sa i përket ankesës në lidhje me shkeljen e nenit 8 të KEDNJ-së, Paneli theksoi se ai "nuk ka gjetur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar, e para, se mbetjet mortore të gruas së ankuesit vërtetë ishin zhvendosur nga varri, dhe e dyta, se ankuesi ishte ankuar tek autoritetet relevante të UNMIK-ut rreth asaj, apo që ai kishte kërkuar pa sukses nga UNMIK-u ta gjejë vendndodhjen e mbetjeve të saj mortore. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, duke pasur parasysh dëshminë para tij, Paneli nuk është në gjendje të konstatojë një shkelje të nenit 8. Paneli përsërit keqardhjen e vet që ankuesi deri më tani nuk ka qenë gjendje ta gjejë vendin ku përfundimisht pushojnë mbetjet mortore të gruas së tij, e cila padyshim i shkaktoi atij dhimbje dhe vuajtje. Megjithatë, Paneli nuk gjen dëshmi të mjaftueshme se autoritetet e UNMIK-ut interferuan në çfarëdo mënyre në të drejtën e ankuesit në jetë familjare" (shih PKDNJ, *Joviçiq*, lënda nr. 233/09, mendimi i 24 qershorit të vitit 2015, §§ 81-87, 96-98).

5.4 E drejta në jetë - neni 2 i KEDNJ-së – e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues - neni 3 i KEDNJ-së dhe e drejta në jetë familjare - neni 8 i KEDNJ-së

66. Në rastin *N.M. dhe të tjerët* ankues ishin 138 pjesëtarë të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian (RAE) në Kosovë të cilët banonin në pesë kampe të administruara nga UNMIK-u për personat e zhdukur së brendshme (PZHB-të) në gjithë Mitrovicën veriore (Zhikoc, Cesminluke, Kablare, Leposaviq, dhe Osterode). Ata ishin vendosur atje pasi që shtëpitë e

tyre në Mitrovicën jugore ishin shkatërruar në vitin 1999, pas dhunës ndëretnike dhe shkatërrimit të shtëpive të tyre.

67. Gjatë konfliktit të vitit 1999 në Kosovë, shumë romë të cilët kishin jetuar më parë në vendbanimin Lagjja e Romëve në Mitrovicën jugore kishin ikur në Mitrovicën veriore si rezultat i dhunës ndëretnike dhe shkatërrimit të shtëpive të tyre. Përafërsisht 600 romë ishin vendosur në kampet për PZHB në (Zhikoc, Cesminluke, Kablare, Leposaviq, dhe Osterode) afër Shkritores Trepça dhe lokacioneve të saj që përdoreshin për të lënë mbetjet nga punimet në miniera.

68. Përafërsisht gjysma e ankuesve ishin fëmijë kur ankesa iu dorëzua Panelit. Rreth 75 ankues janë gra dhe vajza. Së paku 13 nga to lindën fëmijë në kampe dhe kanë dorëzuar ankesë po ashtu në emër të fëmijëve të tyre.

69. Të gjithë ankuesit pohojnë se kanë përjetuar helmim nga plumbi dhe më pas kanë pasur probleme shëndetësore për shkak të kontaminimit të dheut në vendet ku ishin kampet për shkak të afërsisë së tyre me Shkritoren Trepça dhe Kompleksin e Minierave dhe për shkak të përgjithësisht higjienës dhe kushteve jetësore të këqija në kampe. Katër ankues pohojnë se anëtarët e tyre të familjes vdiqën në kampe si rezultat i helmimit nga plumbi.

70. Paneli konsideroi se i takonte UNMK-ut në këtë rast të hedhë poshtë pretendimet prima-facie të paraqitura nga ankuesit dhe të shpallura të pranueshme nga Paneli. Paneli e kishte parasysh faktin se asnjë dokumentacion nuk është paraqitur nga UNMIK-u, pavarësisht nga njohuritë e veçanta që UNMIK-u i kishte apo është dashur t'i ketë rreth gjendjes shëndetësore në kampe dhe pavarësisht kërkesave të përsëritura të Panelit për t'i dorëzuar veçanërisht ato dokumente që referohen në apo mbështeten nga PSSP-ja, dhe konsideroi se ligjërisht mund të nxjerrë "konkluzione të forta" nga dokumentacioni në dispozicion në dosje.

71. Paneli gjeti se UNMIK-u kishte shkelur të drejtën e ankuesve në jetë, në aspektet e veta esenciale dhe procedurale, siç garantohet me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), të drejtën e tyre për të qenë të lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues (Neni 3 i KEDNJ-së) dhe të drejtën e tyre për të respektuar jetën private dhe familjare (Neni 8 i KEDNJ-së). Paneli konsideroi se dështimi i UNMIK-ut për t'i rivendosur ata në një ambient të sigurt paraqiste diskriminim kundër ankuesve si pjesëtarë të komunitetit RAE në shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së, marrë në lidhje me dispozitat e KEDNJ-së të përmendura më lart, të neneve 2 dhe 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenit 2 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK).

72. Paneli ka gjetur më tutje që kushtet jo të shëndetshme dhe johigjienike në kampe përbënin një shkelje të të drejtave të ankuesve për një standard adekuat të jetesës, duke përfshirë të drejtën për banim (Neni 11 i KNDESK-së) dhe të drejtës për standardin më të lartë të arritshëm sa i përket shëndetit (Neni 12 i KNDESK-së).

73. Në lidhje me ankueset femra, Paneli konsideroi se ato po ashtu iu nënshtruan diskriminimit të shumëfishtë në gëzimin e të drejtave të tyre fundamentale, si gra, si PZHB dhe si

pjesëtare të komunitetit RAE në shkelje të Konventës mbi Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (KEDKG). Paneli po ashtu e gjeti UNMIK-un përgjegjës për rrezikimin pakthyeshëm të jetës, shëndetit dhe potencialit zhvillimor të ankuesve që ishin lindur dhe rritur si fëmijë në kampe në shkelje të neneve 3, 6, 24, 27 dhe 37 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

74. Paneli i ofroi një numër rekomandimesh UNMIK-ut duke përfshirë, në mes gjërave tjera, të pranojë publikisht dështimin e vet për të përmbushur standardet e aplikueshme për të drejtat e njeriut në përgjigje të gjendjes së pafavorshme shëndetësore të shkaktuar nga kontaminimi me plumb në kampet për PZHB dhe dëmet pasuese të përjetuara nga ankuesit, dhe t'u kërkojë falje publike atyre dhe familjeve të tyre.

75. Paneli po ashtu rekomandoi që UNMIK-u të ndërmarrë hapat e duhur drejt pagesës së kompensimit adekuat për dëmin material dhe moral në lidhje me gjetjen e shkeljeve të dispozitave për të drejtat e njeriut të përmendura në mendim.

76. Paneli po ashtu rekomandoi që UNMIK-ut të ndërmarrë hapa të duhur për të siguruar që organet e OKB-së që punojnë me refugjatët dhe PZHB-të të promovojnë dhe sigurojnë respektimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe që të gjeturat dhe rekomandimet e Panelit në këtë rast të ndahen me organet e tilla, si një garanci për mospërsëritje. Paneli po ashtu rekomandoi që UNMIK-u të marrë hapa të duhur drejt organeve të OKB-së për të siguruar shpërndarje efektive të informatave relevante për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve nën autoritetin dhe kontrollin e tyre.

77. Përveç kësaj, Paneli rekomandoi që UNMIK-u t'u kërkojë organeve të OKB-së dhe autoriteteve relevante në Kosovë të mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut të romëve, veçanërisht grave dhe fëmijëve, duke siguruar që ata kanë një rol proaktiv.

5.5. E drejta në jetë (procedurale) – e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues – e drejta për një hetim efektiv – të drejtat sipas KEDKG-së

78. Në rastin *S.M.*, ankuesi u ankua se kishte pasur një hetim joefektiv pasi ajo është sulmuar në shtëpinë e tyre familjare në fshatin Bellopole të Komunës së Pejës, nga shumë persona shqiptarë, duke përfshirë njërin që kishte veshje me simbole të UÇK-së. Sulmuesit e sulmuan atë, ia lidhën sytë dhe e lidhën për një karrige, dhe pastaj në një distancë që mund të dëgjohet tre nga ta përdhunuan vajzën e saj, znjsh. X., e cila ishte me paaftësi fizike dhe mendore. Pastaj ata e vranë atë duke e prerë në fyt me brisk rroje.

79. Lidhur me hetimin joefektiv, Paneli së pari theksoi që "nuk ka asnjë dëshmi në dosje se ishte bërë ndonjëherë ndonjë hetim i veçantë për përdhunimin dhe vrasjen e znjsh. X. PSSP-ja pranon të njëjtën kur ai thotë 'sa i përket hetimit që kishte për qëllim identifikimin dhe sjelljen para drejtësisë të autorëve të cilët janë përgjegjës për vdekjen e [znj. X.] është e paqartë, duke u bazuar në dosjet e pranuara nga EULEX-i, nëse ishte kryer ndonjë hetim. Ngjashëm, është e paqartë nëse hetimet për vdekjen e saj ishin pjesë e hetimeve të kryera për rastin tjetër (shih § **Error! Reference source not found.** më lart).' Sidoqoftë, Paneli thekson se nuk ka asnjë dëshmi në dosje për ndonjë aktivitet tjetër hetimor apo veprim

tjetër kuptimplotë të ndërmarrë nga Policia e UNMIK-ut gjatë periudhës nën juridiksionin e përkohshëm të Panelit.”

80. Lidhur me të drejtën për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues, Paneli theksoi që “ankesat sipas obligimit procedural të nenit 3 të KEDNJ-së, janë të njëjta me ato që tanimë i ka shqyrtuar sipas obligimit procedural të nenit 2 të KEDNJ-së. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, çështjet kryesore ligjore që dalin nga këto ankesa tanimë janë shqyrtuar sipas nenit 2, në lidhje me të cilat ka gjetur shkelje. Prandaj Paneli, si rregull, e konsideron të panevojshme të përcaktohet ndaras nëse në rastin aktual ka pasur shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Megjithatë, për shkak të brutalitetit në këtë rast dhe rëndësisë së pranimit të ndodhjes së dhunës seksuale gjatë dhe pas konfliktit, Paneli e sheh të nevojshme ta shtjellojë çështjen. Paneli thekson që, sa i përket peshës së dëshmisë, UNMIK-u nuk është liruar nga obligimi i vet në lidhje me këtë, pasi nuk ka paraqitur dosje të plotë hetimore e as që ka sqaruar në një mënyrë “të kënaqshme dhe bindëse” dështimin e vet për ta bërë këtë. Prandaj, Paneli do të nxjerrë konkluzione nga kjo situatë.”

81. Duke iu kthyer rrethanave të rastit aktual, Paneli rikujton që “znjsh. X. është përdhunuar në mënyrë brutale dhe vrarë dhe znj. M. është sulmuar më 26 qershor 1999, menjëherë pas vendosjes së UNMIK-ut në Kosovë. Paneli, po ashtu, rikujton që përdhunimi paraqet trajtim johuman dhe degradues, i tillë që UNMIK-u ishte i obliguar ta hetojë atë, dhe çdo dështim për ta bërë këtë përbën shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Paneli, po ashtu, i merr veçanërisht parasysh aktet mizore në këtë rast, në mënyrë specifike që znjsh. X., një femër me paaftësi fizike dhe mendore, ishte sulmuar nga shumë persona të armatosur, pastaj ishte përdhunuar brutalisht dhe ishte therë duke e prerë në fyt me brisk rroje. Në ndërkohë, nëna e saj e moshuar ishte sulmuar, lidhur për karrige dhe i ishin mbyllur sytë nga persona të armatosur para se të detyrohej ta dëgjonte britmën e vajzës së saj derisa përdhunohej dhe therej në dhomën tjetër.”

82. Paneli konstatoi se “një situatë e tillë e neveritshme zakonisht klasifikohet të ketë arritur pragun e torturës. Kjo është e qartë për sa i përket znjsh. X. ku akumulimi i akteve të dhunës fizike dhe veçanërisht akti mizor i përdhunimit, të cilit ajo iu nënshtrua, përbën torturë në shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Trajtimi të cilit iu nënshtrua nëna e saj znj. M., po ashtu, përbën torturë pasi ajo ishte e detyruar ta duronte situatën si dëshmitare në tmerrin ndërsa veprohej në vajzën e saj me paaftësi mendore. Në fakt, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara edhe vetë i ka pranuar “ata që janë traumatizuar për së dyti si dëshmitarë të detyruar me forcë të dhunës seksuale kundër anëtarëve të familjes së tyre”. Ngjashëm, Paneli thekson se GJNADNJ ka gjetur se përdhunimi në praninë e një anëtari të familjes ka rëndësi të veçantë dhe serioze, duke e rritur poshtërimin e viktimës dhe traumën për ata të dy. Në një rast të tillë, Paneli gjen se UNMIK-u e kishte për obligim të kryejë një hetim, në pajtim me nenin 3 të KEDNJ-së. Megjithatë, Paneli tanimë ka gjetur se nuk ka asnjë indikacion në dosjet hetimore se UNMIK-u kreu një hetim efektiv për gjetjen e autorëve të këtyre krimeve dhe sjelljen e tyre para drejtësisë.”

83. Prandaj, Paneli përfundoi “që UNMIK-u dështoi të kryejë hetim efektiv për sulmimin dhe përdhunimin e znjsh. X. dhe sulmimin e znj. M. Pra, është bërë një shkelje e obligimit procedural sipas nenit 3 të KEDNJ-së dhe nenit 7 të KNDCP-së.”

84. Në fund, lidhur me shkeljet e KEDKG-së, Paneli theksoi se "se njëra nga viktimat në këtë rast, znjsh. X, ishte një grua me paaftësi e cila iu nënshtrua një incidenti të tmerrshëm të dhunës seksuale të bazuar në gjini, të drejtuar kundër saj për shkak të etnisë së saj dhe për shkak se ajo ishte grua. Në një rast të tillë, Paneli thekson që në pajtim me Rekomandimin e Përgjithshëm të KEDKG-së nr. 19, UNMIK-u e kishte për obligim të veprojë me kujdesin e duhur për të hetuar, ndjekur penalisht dhe dënuar aktin e dhunës që ishte kryer ndaj saj. Megjithatë, Paneli përsërit se nuk ka asnjë dëshmi në dosje se UNMIK-u kreu çfarëdo qoftë hetimi për përdhunimin e znjsh. X.. Në rrethana të tilla, Paneli përfundon që znjsh. X. iu nënshtrua dhunës të bazuar në gjini që nuk ishte hetuar me kujdesin e duhur nga UNMIK-u, duke u shkelur dispozitat relevante të Konventës KEDKG" (shih PKDNJ, *S.M.*, lënda nr. 342/09, mendimi i 18 marsit të vitit 2016, §§ 134-141, 148-149).

5.6 E drejta në liri – e drejta për hetim efektiv - neni 5 i KEDNJ-së

85. Në rastin *Kostiq dhe të tjerët*, disa nga ankuesit u ankuan se UNMIK-u nuk bëri hetim efektiv për krimet në të cilat anëtarët e tyre të familjes ishin rrëmbyer më 18 korrik 1998 gjatë një sulmi të armatosur nga UÇK-ja në fshatrat Opterushë dhe Retimlë të Komunës së Rahovecit dhe më pas u mbajtën nga UÇK-ja në manastirin "Shëruesit e shenjtë" në fshatin Zoqishtë të Komunës së Rahovecit para se të transferoheshin dhe më vonë të liroheshin. Pas shqyrtimit të dosjes hetimore, Paneli së pari gjeti se UNMIK-u kishte bërë shkelje të obligimit procedural të nenit 2 të KEDNJ-së përmes hetimit të vet joefektiv. Pastaj, lidhur me nenin 5 të KEDNJ-së, Paneli theksoi si në vijim: "Fakte të padiskutueshme janë që një numër civilësh, duke përfshirë znj. Anxhelina Kostiq, znj. Petra Kostiq, znj. Sllavica Banziq, znj. Desanka Banziq dhe znj. Dragica Bozhaniq, ishin rrëmbyer nga UÇK-ja prej shtëpive të tyre, më 18 korrik 1998, ishin ndarë nga burrat e familjeve të tyre, ishin mbajtur, dhe më pas ishin liruar te KNKK më 22 korrik 1998.Ky grup përbëhej kryesisht prej grave, por gjithashtu kishte disa persona të moshuar dhe ata me paaftësi, murgj ortodoksë dhe fëmijë. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, kjo ndarje dhe më pas mbajtje kishte prekur gratë në mënyrë joproporcionale. Së këndejmi UNMIK-u ishte i obliguar të hetojë me kujdesin e duhur këtë akt të dhunës të bazuar në gjini. Paneli thekson që, pavarësisht nga kohëzgjatja e kufizuar, rrëmbimi i ankueseve dhe privimi nga liria për katër ditë nga ana e UÇK-së paraqiste mbajtje ilegale në kuptim të nenit 5 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton që ato ishin mbajtur një ditë dhe një natë nën roje të armatosur në një kamp."

86. Paneli po ashtu theksoi që "ka një rrezik shtesë, duke përfshirë dhunën seksuale që ekziston për gratë dhe vajzat kur ato privohen nga liria, duke përfshirë situatat e konfliktit të armatosur. Sipas mendimit të Panelit, hetimi i ndonjë situate kur gratë privohen nga liria nga një palë në konfliktin e armatosur duhet të marrë parasysh mundësinë potenciale për dhunën seksuale dhe të bazuar në gjini kundër tyre. Një hetim efektiv në rrethana të tilla duhet të kryhet në mënyrë të ndjeshme sa i përket gjinisë. Në lidhje me këtë, Paneli thekson që Komiteti i KEDKG-së (CEDAW), në rekomandimin e vet të përgjithshëm nr.33, rekomandon që palët shtetërore të sigurojnë që 'profesionistët e sistemeve gjyqësore trajtojnë rastet në një mënyrë të ndjeshme sa i përket gjinisë' ". Paneli konsideroi që mbajtja e viktimave kërkonte një hetim nga autoritetet kompetente, në këtë rast nga UNMIK-u, me vendosjen e tij në Kosovë.

87. Paneli rikujtoi që ai "tanimë ka gjetur që ky hetim nuk ka plotësuar kërkesat për efektivitet sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Paneli thekson më tutje që dosja hetimore nuk pasqyron ndonjë masë specifike në vend për të siguruar që çdo informatë në lidhje me rrezikun potencial që gratë mund t'i jenë ekspozuar gjatë mbajtjes së tyre ilegale nga UÇK-ja ishte mbledhur, ruajtur, analizuar dhe shfrytëzuar për të identifikuar rastet e dhunës kundër grave dhe sjelljen e autorëve para drejtësisë. Regjistrimet e intervistave me ankueset dhe të mbijetuarit tjerë të rrëmbimit dhe mbajtjes në korrik të vitit 1998, tregojnë që çështjet e gjinisë dhe cenueshmëria shtesë nuk ishin marrë parasysh nga autoritetet ashtu siç e kërkonte situata e ankueseve. Në veçanti, dosja hetimore në posedim të Panelit tregon që vetëm dy viktima, znj. Petra Kostiq dhe znj. Anxhelina Kostiq, ishin intervistuar nga TNPJ dhe Policia e UNMIK-ut. Paneli thekson se këto intervista, dhe po ashtu intervistat me dëshmitarët tjerë, duke përfshirë të mbijetuarat femra dhe fëmijë të rrëmbimit dhe mbajtjes, ishin kryer nga hetuesit meshkuj. Paneli është i shqetësuar që këto mangësi në hetime mund të kenë rezultuar me humbjen e informatave rreth llojeve të dhunës kundër civilëve në Kosovë."

88. Paneli po ashtu rikujtoi që "mungesa e informatave në lidhje me abuzimet e mundshme të grave nga UÇK-ja gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë tanimë ishte pranuar nga hetuesit. Paneli është po ashtu i shqetësuar që mungesa e një hetimi të tillë mund t'i kontribuojë mungesës së përgjithshme të informatave dhe dokumenteve rreth dhunës kundër grave në Kosovë, dhe kështu paraqet pengesa shtesë për viktimat në përpjekjet e tyre për të pasur ndonjë formë të dëmshpërblimit për vuajtjen e tyre. Prandaj, Paneli, në dritë të gjetjes së një shkelje të obligimit procedural të nenit 2 të KEDNJ-së, konstaton se kishte po ashtu shkelje të të drejtave të znj. Anxhelina Kostiq, znj. Petra Kostiq, znj. Sllavica Banziq, znj. Desanka Banziq dhe znj. Dragica Bozhaniq, të garantuara sipas nenit 5 të KEDNJ-së (shih PKDNJ, *Kostiq dhe të tjerët*, lëndët nr. 111/09 dhe të tjerët, mendimi i 23 tetorit të vitit 2015, §§ 338-346).

5.7 E drejta për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues – e drejta në sigurim social dhe në standard adekuat të jetesës

89. Në rastin *B.K.* ankuesi u ankua se UNMIK-u ndihmoi deportimin e tij në Kosovë pas njëzet e tre vjetësh të qëndrimit të vazhdueshëm në ShBA, pa i ofruar atij ndonjë ndihmë pas arritjes në Kosovë, duke e lënë pa strehim dhe ushqim të duhur, pa qasje në përkujdesje themelore sociale dhe mjekësore, pa punë dhe mjete financiare për të mbajtur veten. Paneli konsideron se ankuesi thirret në shkelje të së drejtës së tij për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues siç parashihet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ-së), si dhe në shkelje të së drejtës së tij për punë, siguri sociale dhe për standard adekuat të jetesës siç garantohet me nenet 6, 9 dhe 11 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK).

90. Në përgjigje ndaj vërejtjes së PSSP-së që të drejtat ekonomike dhe sociale nuk garantohen sipas KEDNJ-së, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane, duke theksuar që nuk ka "ndarje të plotë që ndan atë sferë nga fusha e të drejtave civile dhe politike që mbulohen nga Konventa" dhe që, për shembull një shumë plotësisht e pamjaftueshme e pensionit dhe përfitimeve sociale mund të ngritë një çështje sipas nenit 3 të Konventës. Gjykata ka theksuar që, si pasojë, ajo nuk mund ta përjashtojë mundësinë që

përgjegjësia e shtetit mund të gjendet sipas nenit 3 për trajtimin ku një ankues, i cili plotësisht ka qenë i varur nga përkrahja e shtetit, e gjen veten përballë indiferencës zyrtare në një situatë të varfërisë apo nevojës serioze në kundërshtim me dinjitetin njerëzor. Paneli thekson që …UNMIK-u e kishte një përgjegjësi sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1244 (1999) dhe më pas rregulloreve të UNMIK-ut për të krijuar një sistem për kthimin e personave të riatdhesuar me origjinë nga Kosova, i cili plotësisht do të ishte në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të aplikueshme për UNMIK-un, duke përfshirë ato që rrjedhin nga KEDNJ dhe KNDESK. Paneli thekson që, në të vërtetë, në periudhën mes viteve 2006 dhe 2007, UNMIK-u krijoi së bashku me IPVQ-të e Kosovës Politikën për kthim dhe Strategjinë për ri-integrim për këtë qëllim. Paneli thekson që, në Politikën për kthim, qartë thuhet që UNMIK-u ruajti kompetencat e përgjithshme për implementimin e procedurave të kthimit.”

91. Paneli theksoi më tutje që “deri më 15 qershor 2008, UNMIK-u vazhdoi t’i ushtrojë kompetencat ekzekutive në Kosovë, duke përfshirë ato që ndërlidhen me procedurat e kthimit, siç janë theksuar më lart. Në fakt, pranohet qartë nga PSSP-ja, që UNMIK-u ishte në parim përgjegjës për sigurimin e një niveli minimal të ndihmës bazë ankuesit në periudhën në mes arritjes së tij në Kosovë më 6 maj 2008 dhe 15 qershorit të vitit 2008. Megjithatë, PSSP-ja pohon që i takonte ankuesit t’i kontaktojë autoritetet relevante për t’i informuar ato për nevojën e tij për ndihmë dhe se ai nuk e dëshmoi se e bëri këtë, e as që e dëshmoi se UNMIK-u reagoi në mënyrë jo të duhur apo me indiferencë ndaj kërkesës së tij për ndihmë. Paneli thekson se një sistem efektiv i ndihmës pas riatdhesimit duhet t’i ketë të vendosura në vend procedurat, përmes të cilave mund të identifikohen personat e cenueshëm në nevojë të ndihmës dhe mbrojtjes së veçantë. Në të vërtetë Strategjia për ri-integrim e UNMIK-ut-IPVQ-ve e vitit 2007 për personat e riatdhesuar parashihte që të gjithë të kthyerve duhet ofruar “pritje fillestare dhe ndihmë në informata” në Aeroportin e Prishtinës nga stafi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me qëllim të identifikimit të nevojave të menjëhershme, si dhe nevojave afatgjata të të kthyerve dhe t’ia përcjellë informatat e tilla Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Prandaj, Paneli përfundon që, madje edhe nëse për disa arsye letrat që përmbanin një kërkesë për ndihmë që thuhet se ankuesi ia dërgoi UNMIK-ut, nuk i ishin përcjellë zyrës apo personit relevant, një sistem efektiv për riatdhesim që është në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, është dashur të jetë në dispozicion dhe në gjendje ta identifikojë ankuesin si një person i cenueshëm, të vlerësojë nevojën e tij për ndihmë dhe t’i ofrojë atij mbështetjen e kërkuar.”

92. Paneli, po ashtu, theksoi se “ka dëshmi për dështimet dhe të metat në implementimin e Politikës për kthim dhe Strategjisë për ri-integrim të UNMIK-ut-IPVQ-ve. Për shembull …në raportin e vet të nëntorit të vitit 2009 mbi implementimin e Strategjisë për ri-integrim, OSBE-ja theksoi që, nga miratimi i saj në vitin 2007 ‘vetëm disa hapa’ ishin ndërmarrë për ta zbatuar strategjinë në nivel lokal. Në këtë raport thuhet, në veçanti, se kishte një mungesë të përgjithshme të vetëdijes në mesin e autoriteteve relevante lokale për rolet dhe përgjegjësitë e tyre për riatdhesimin e personave, se nuk ishin miratuar masa konkrete për të ndihmuar ri-integrimin e tyre, dhe se nuk ishte krijuar asnjë mekanizëm referimi dhe asnjë shpenzim nuk ishte ndërlidhur me procesin e ri-integrimit.”

93. Pastaj, Paneli theksoi që "madje edhe duke pranuar përgjegjësinë e UNMIK-ut për t'u ofruar ndihmë minimale bazë të riatdhesuarve, veçanërisht më të cenueshmëve, PSSP-ja thekson që vetë ankuesi nuk do të hynte në këtë kategori, duke pasur parasysh faktin që ai është një 'banor i zakonshëm' i Kosovës, prandaj nuk varet plotësisht nga mbështetja e shtetit. Në lidhje me këtë, Paneli nuk pajtohet me PSSP-në që ankuesi mund të quhej një banor i zakonshëm i Kosovës në momentin e riatdhesimit të tij, duke pasur parasysh faktin (që nuk kontestohet nga PSSP-ja) që, para riatdhesimit, ai kishte jetuar pandërprerë për 23 vjet në ShBA. Paneli konsideron që, pas një mungese të tillë të gjatë nga Kosova, e cila përfshiu konfliktin e armatosur, si dhe pas transformimeve të mëdha sociale dhe politike në Kosovë, ankuesi nuk ishte më një pjesëtar i integruar i shoqërisë së Kosovës. Paneli, po ashtu, thekson që ankuesi thotë se ai ishte i prekur nga një sëmundje që nga lindja. Në çdo rast, Paneli po ashtu thekson faktin që të qenit "banor" nuk do ta mbronte një person nga shkelja e të drejtave të tij themelore ekonomike dhe sociale. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të përmendur më lart që madje edhe ata banorë që marrin pension apo përfitime të tjera sociale mund të pretendojnë për shkelje të nenit 3, kur këto janë "plotësisht të pamjaftueshme" për të jetuar me dinjit**et**. Në fund, Paneli rikujton që Gjykata Evropiane ka gjetur shkelje të nenit 3 madje edhe në rastet në të cilat situata në skamje serioze, varfëri dhe nevojë për ata që u nevojitej mbrojtje e veçantë ka zgjatur për një periudhë kohore prej dy javësh."

94. Prandaj, Paneli përfundoi që "ankuesi ishte në një situatë që kërkonte nivel të ndihmës bazë nga UNMIK-u për t'i plotësuar nevojat e tij elementare në periudhën menjëherë pas deportimit të tij në Kosovë të cilën, megjithatë, ai nuk e mori për shkak të dështimit të sistemit për të identifikuar dhe vlerësuar nevojën e tij për mbështetje. Paneli konsideron që, për periudhën prej 6 majit të vitit 2008 deri më 15 qershor 2008, dështimi i tillë i atribuohet UNMIK-ut. Paneli konsideron që ankuesi, si rezultat i dështimit të UNMIK-ut të përshkruar më lart pas deportimit të tij të detyrueshëm nga ShBA-ja, u gjet në një situatë të varfërisë dhe nevojës ekstreme që përbën trajtim jonjerëzor dhe degradues në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së. Paneli, po ashtu, konsideron që niveli shumë i kufizuar i ndihmës që UNMIK-u ia ofroi ankuesit nuk përmbushi obligimet minimale bazë sipas nenit 9 dhe 11 të KNDESK-së për t'i ndërmarrë hapat e duhur, deri në maksimum të resurseve në dispozicion, për të realizuar të drejtën e ankuesit për një standard adekuat të jetesës (neni 11) dhe siguri sociale (neni 9). Megjithatë, Paneli nuk konsideron që periudha në të cilën UNMIK-u ruajti përgjegjësitë ekzekutive është e mjaftueshme për të konstatuar, po ashtu, shkelje të së drejtës së ankuesit për punë, siç parashihet me nenin 6 të KNDESK-së" (shih PKDNJ, *B.K.*, lënda nr. 85/10, mendimi i 13 nëntorit 2015, §§ 44-53).

95. Në rastin *Tomë Krasniqi*, ankuesi u ankua se UNMIK-u nuk i ndihmoi atij ta pranojë pensionin e tij kontribuues që nga 12 dhjetori i vitit 1998 deri në muajin prill të vitit 2007 duke u bazuar në vitet e kontributit të tij në Fondin jugosllav për Pensionistë dhe Persona Invalidorë e cila është në shkelje e së drejtës së tij për ta shfrytëzuar i qetë pasurinë në pajtim me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Ai po ashtu u ankua se për shkak të mospagesës së pensionit të tij "kontribuues" gjatë periudhës prej vitit 1999 deri më 2007, dhe për shkak të pamjaftueshmërisë të pensionit të moshës që i është dhënë atij pas kësaj, ai ka mbetur pa mjete financiare për të mbajtur veten. Në lidhje me këtë, ankuesi pretendon në shkelje të së drejtës së tij për sigurim social dhe për standard adekuat të jetës të garantuar me nenet 9 dhe 11 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike,

Sociale dhe Kulturore (KNDESK), si dhe në shkelje të së drejtës së tij për të qenë i lirë nga trajtimi johuman dhe degradues e garantuar me nenin 3 të KEDNJ-së.

96. Për sa i përket pretendimit sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Paneli së pari vlerësoi nëse UNMIK-u miratoi masa adekuate, në kuadër të kufizimeve të autoritetit dhe mandatit të vet, për t'i mbrojtur dhe garantuar të drejtat në pension të ankuesit. Paneli theksoi argumentimin e PSSP-së se "në mes vitit 1999 dhe 2002 ishin bërë përpjekje diplomatike në forma të një varg takimesh 'pa u shprehur hapur dhe konfidenciale' në mes zyrtarëve të UNMIK-ut dhe autoriteteve serbe, në të cilat ishte trajtuar çështja e pensioneve", megjithëse kjo kohë ishte jashtë juridiksionit të vet kohor. Paneli theksoi se" nuk është bindur se janë marrë masa konkrete gjatë kësaj periudhe për t'i mbrojtur të drejtat në pension të atyre që kishin të drejtë, duke përfshirë ankuesin, meqë asnjë dokumentacion mbështetës nuk është ofruar nga PSSP-ja, i cili qartëson shtrirjen apo rezultatin e përpjekjeve të tilla diplomatike. Megjithatë, Paneli po ashtu thekson se në përpjekje për të zgjidhur problemin e pensioneve në Kosovë, në vitin 2001, UNMIK-u krijoi nga fillimi një Skemë të re pensionale në Kosovë, e cila u bë funksionale duke filluar nga viti 2002. Paneli thekson që ky sistem u ofroi pensione bazë të moshës të gjithë atyre mbi 65 vjeç, pavarësisht nga ndonjë punësim i mëparshëm. Shuma mujore e këtij pensioni ishte 28 euro në vitin 2002, 35 euro në vitin 2003 dhe 45 euro nga viti 2004 deri më 2008."

97. Paneli po ashtu potencoi se "[d]uke ardhur te periudha nën juridiksionin e përkohshëm të Panelit, nga 23 prilli i vitit 2005, Paneli thekson që ankuesi ishte kualifikuar të pranojë një pension bazë të moshës sipas Skemës pensionale të Kosovës të krijuar nga UNMIK-u që nga viti 2003, kur ai u bë 65 vjeç. Në të vërtetë, sipas një vendimi të Gjykatës Supreme të paraqitur nga ankuesi, ai e kishte pranuar një pension të tillë që nga maji i vitit 2003. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se UNMIK-u, në kuadër të kufizimeve të kompetencave të veta dhe në pajtim me mandatin e vet sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), ndërmori të gjitha hapat e mundshëm për t'i përmbushur obligimet e veta pozitive sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Prandaj, Paneli konstaton se UNMIK-u nuk e shkeli të drejtën e ankuesit në pronë."

98. Lidhur me pretendimet e ankuesit sipas nenit 9 dhe 11 të KNDESK-së për të marrë hapa të duhur, deri në maksimum të burimeve në dispozicion, për të përmbushur të drejtën e tij për standard adekuat të jetesës (Neni 11) dhe sigurim social (Neni 9), Paneli së pari përdori parimet e përgjithshme për rastin. Ai theksoi që "ankuesit i ishin ofruar përfitimet sipas ish-sistemit jugosllav, dhe në mënyrë specifike një pension kontribuues i barasvlershëm me 180 euro në muaj, të cilat ai i pranoi deri në dhjetor të vitit 1998. Paneli, po ashtu, theksoi që për shkak të situatës politike pas konfliktit të Kosovës dhe nxjerrjes së Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), nën administrimin e UNMIK-ut gjatë periudhës 1999-2001, ankuesi nuk kishte përfitime pensionale dhe ndonjë mbrojtje tjetër sociale."

99. Megjithatë, Paneli po ashtu theksoi që "duke filluar nga viti 2002, UNMIK-u veproi në pajtim me obligimin e vet sipas KNDESK-së, në mënyrë specifike nenit 9 të Konventës, për të krijuar një skemë të sigurimit social e cila përfshinte jokontribuuesit dhe kontribuuesit, pensionet e moshës, dhe të fundit ofroheshin sipas ligjit nga mosha 65 vjeç. Paneli thekson më tutje se kjo skemë fillimisht nuk përmbante dispozitat për ata punëtorë të

cilët kishin paguar kontribute në ish-sistemin jugosllav, sikur ankuesi. Megjithatë, sipas kësaj skeme, ankuesi mori që nga momenti kur e fitoi të drejtën në vitin 2003 një pension të moshës, shuma fillestare e të cilit ishte 35 euro në muaj. Duke ardhur te periudha nën juridiksionin e vet, Paneli thekson se ankuesi pranoi në këtë periudhë një pension të moshës prej 45 eurosh në muaj. Vetëm nga shtatori i vitit 2009, jashtë juridiksionit të përkohshëm të Panelit, ankuesi filloi të marrë një pension kumulativ prej 80 eurosh, duke u bazuar në moshën e tij si dhe kontributet e mëparshme në Sistemin pensional jugosllav."

100. Paneli konsideroi se "përmes krijimit të një skeme pensionale në Kosovë, e cila përfshinte kontribuuesit dhe jokontribuuesit e moshuar, UNMIK-u veproi në pajtim me obligimet e veta sipas KNDESK-së, dhe në veçanti sipas nenit 9 të Konventës. Megjithatë, Paneli është i shqetësuar që shuma mujore e pensionit për të moshuar e paraparë në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/31 dhe si e tillë i është ofruar ankuesit në periudhën nën juridiksionin e Panelit - 45 euro në muaj, që është rreth një euro e gjysmë në ditë – nuk ishte adekuate për t'i siguruar qasje ankuesit në shërbimet themelore dhe të mirat e nevojshme për realizimin e një standardi adekuat të jetesës dhe shëndetit. Në lidhje me këtë, Paneli e ka parasysh deklaratën e ankuesit se pensioni i tij nuk ishte madje i mjaftueshëm për t'i blerë barnat që atij i nevojiteshin."

